

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore re
Titulli i lëndës:	Analizimi i të dhënave në ekologjike dhe mjedisore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obliguese
Viti i studimeve:	Viti i tret/semestri dimëror
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Departamenti i Biologjisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. asoc. dr. Avni Hajdari
Detajet kontaktuese:	avni.hajdari@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Kurs do të ju ofrojë një pasqyrë për metodologjitë statistikore që përdoren hartimin, analizimin, interpretimin dhe paraqitjen e të dhënave eksperimentale dhe hulumtimeve ekologjike dhe mjedisore. Kursi do të mbulojë temat si statistikat përshkruese, elementet e dizajnit eksperimental, probabilitetin, testimin e hipotezave dhe përfundimeve statistikor, analizën e variancës, korrelacionin dhe regresionin, si dhe statistikat me shumë ndryshore. Gjatë implementimit të kursit do të theksohet aplikimi i teknikave statistikore brenda kontekstit ekologjik, duke përdorur të dhëna laboratorike dhe/ose të dhëna nga studimet në terren. Puna laboratorike do të përfshijë analizën e të dhënave duke përdorur programet në Excel, PAST dhe /ose PSPP.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kursit është ti sigurojë studentëve mjetet e nevojshme për të organizuar të dhënat statistikore që rezultojnë nga studimet eksperimentale dhe hulumtimet në terren, si dhe të analizojë këto të dhëna duke përdorur metoda të përshtatshme statistikore.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studenti duhet të jetë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> - Llogarit dhe interpretojë të dhënat statistikore për grupet e të dhënave, - Konstruktojnë dhe interpretojë saktë intervalet e besueshmërisë për pikat e vlerësimeve, - Kuptojnë përdorimin dhe interpretimin e drejt të niveleve të signifkancës (vlerat p), - Njohin dhe kuptojnë i rëndësisë se shpërndarjes se probabilitetit si normal & binomial, - Formulojnë dhe testojnë hipoteza statistikore, - Njohin situatat kur është e përshtatshme të përdoren dhe të kryejnë t-teste (të pavarura ose çifte), analizën e variancës,

	korrelacionit dhe regresionit, si dhe analizat multivariate - Dini të përdorin softueriet statistikor si Excel, PAST dhe/ose PSPP për të përshkruar të dhënat ekologjike dhe për të testuar hipoteza biologjike specifike -		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokfiume,seminare	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	13	13
Përgatitja përfundimtare për provim	4	6	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	2	4
Projektet,prezantimet ,etj	2	2	4
			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Gjatë realizimit të kursit do të kombinohen metodologji të ndryshme të mësimdhënës si: ligjërata, mësim interaktiv, punë në grupe, debate, konsultime, pune praktike, etj.		
Metodat e vlerësimit:	Do të bëhet vlerësim i vazhdueshëm i te gjitha aktiviteteve të studentit, vlerësimi behët në pjesën praktike dhe teorike, përmes vlershmeve intermediere dhe provimit përfundimtar. Përgatitja e rezultateve 30% Vijimi i rregullt 10% Prezantimi i rezultateve 20% Provimi final 40% Total 100% Nota do të llogarite si më poshtë: 51%- 60% = 6 61% -70% = 7 71% - 80% = 8 81% - 90% = 9 91%-100% =10		
Literatura			

Literatura bazë:	Mynyr Koni, Biostatistika, Tiranë, 2015 Philip C. Wheater, James R. Bell, Penny A. Cook, Practical Field Ecology: A Project Guide. John Wiley & Sons, 2011
Literatura shtesë:	Gerry Quinn, Michael Keough, Experimental Design and Data Analysis for Biologists, Cambridge University Press 2002
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje, variabilet ekologjike dhe mjedisore, softuerët që përdoren për analizimin e të dhënave.
Java e dytë:	Mbledhja e të dhënave, llojet e mostrave në ekologji, dhe dizajnimet eksperimentale
Java e tretë:	Rregullat e probabilitetit dhe shpërndarja e tij (Normal & Binomial)
Java e katërt:	Statistika deskriptive (matjet e pozicionit dhe të shpërndarjes), paraqitja grafike e tyre
Java e pestë:	Testet themelore për testimin e hipotezave (për testimin e dallimeve mes mostrave)
Java e gjashtë:	Analiza e variancës (ANOVA) Vlerësimi intermedier
Java e shtatë:	Analizimi i lidhshmërisë mes variabileve (analiza e korrelacionit)
Java e tetë:	Analizimi i lidhshmërisë mes variabileve (analiza e regresionit)
Java e nëntë:	Hyrje në statistikën multivariate (MANOVA dhe MANCOVA)
Java e dhjetë:	Hyrje në modelet e përgjithshme lineare (general linear models)
Java e njëmbëdhjetë:	Hyrje në analizën hierarkike dhe llojeve indikatorë (hierarchical cluster analyses and Indicator species analyses (TWINSPAN)),
Java e dymbëdhjetë:	Analiza e diskriminancës
Java e trembëdhjetë:	Analiza e komponentëve parsore dhe analizën korrespondencës (Principal component analyses and correspondence analyses)
Java e katërbëdhjetë:	Indeksat për vlerësimin e diversitetit biologjik
Java e pesëmbëdhjetë:	Përpunimi grafik i të dhënave Vlerësimi intermedier
Java	Ushtrimet/puna praktike
Java e parë:	Metodat dhe softuerët që përdoren për analizimin e të dhënave.
Java e dytë:	Metodat për mbledhjen e të dhënave ekologjike
Java e tretë:	Llogaritja e probabilitetit
Java e katërt:	Analizimi i të dhënave të statistika deskriptive dhe paraqitja grafike e tyre
Java e pestë:	Testimin e hipotezave
Java e gjashtë:	Analiza e variancës (ANOVA)
Java e shtatë:	Analiza e korrelacionit
Java e tetë:	Analiza e regresionit

Java e nëntë:	Analiza e MANOVA dhe MANCOVA
Java e dhjetë:	Analiza e modelit të përgjithshëm linear
Java e njëmbëdhjetë:	Analiza hierarkike dhe e llojeve indikatorë (TWINSPAN),
Java e dymbëdhjetë:	Analiza e diskriminancës
Java e trembëdhjetë:	Analiza e komponentëve parësore dhe analiza e korrespondencës
Java e katërbëdhjetë:	Indekset për vlerësimin e diversitetit biologjik
Java e pesëmbëdhjetë:	Përpunimi grafik i të dhënave

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar të vijojnë me rregull ligjërata dhe ushtrime. Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit dhe mbajtja e qetësisë në mësime po ashtu janë obligative.

Formular për SYLLABUS të Lëndës: Bimët mjekësore

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN/ Departamenti i Biologjisë
Titulli i lëndës:	Bimët mjekësore
Niveli:	BSC
Statusi lëndës:	zgjedhore
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Sipas orarit të shpallur nga Departamenti
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Fadil Millaku
Detajet kontaktuese:	fadil.millaku@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	Kursi i lëndës Bimët mjekësore do të përfshijë bimët mjekësore dhe aromatike që kanë zbatim në mjekësin farmaceutike dhe në mjekësin tradicionale. Do të mësohen metoda bashkëkohore të identifikimit, përdorimit, vjeljes dhe procesimit të bimëve mjekësore-aromatike dhe pemëve frutore të imta, ruajtjen e bimëve mjekësore – aromatike dhe pemëve frutore të imta si dhe kultivimin e tyre.
Qëllimet e lëndës:	Njohja e studenteve me bimët mjekësore dhe aromatike dhe përdorimi i tyre në mjekësin tradicionale dhe farmaceutike.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde):</p> <p>Studentet do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Jenë në gjendje që të bëjnë identifikimin e Bimëve mjekuese-aromatike. - Kuptojnë rendësin që kanë bimët mjekësore për njerëzimin - T'i njohin bimët mjekuese dhe aromatike si dhe frutat e malit që rriten në Kosovë si bimë të egra apo të kultivuara. - Mësojnë teknikat e vjeljes dhe përdorimit të bimëve mjekësore - Të njohin bimët mjekësore dhe aromatike si produkte gjysmë të përpunuara. - Të mësojnë përhapjen dhe përdorimin e bimëve mjekësore - Të mësojnë ruajtjen dhe kultivimin e bimëve mjekësore dhe aromatike.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokfiume,seminare	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	13	13
Përgatitja përfundimtare për provim	4	6	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	2	4
Projektet,prezantimet ,etj	2	2	4
			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata tradicionale, zbatimi i strategjive të mësimdhënies dhe të nxëniet ndërveprues të cilat nxisin të menduarit konstruktiv përmes leximit dhe shkrimit, punës në grupe, diskutimit, të mësuarit përmes projekteve, zgjedhjes së problemeve, punës laboratorike dhe në terren si dhe prezantime me videoprojektor etj.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Total 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	Ligjërata të përgatitura nga Prof.dr. Fadil Millaku Millaku, F. (2015): Praktikum i Botanikës, Universiteti “Haxhi Zeka” Pejë Rexhepi, F. (2003): Bimët mjekësore, USAID, Prishtinë		
Literatura shtesë:	Ben-Erik van Wyk (2014): Medical plant of the world Ingrid und Peter Schonfeldre (2008): Der neue Kosmos heilpflanzen fuhrer. Stocker Bucherhaus AG. Millaku, F. (2010): Raport për inventarizimin e BMA dhe PFE të Kosovës. MBPZHR, Prishtinë Rexhepi, F. (2003): Bimët mjekësore, USAID, Prishtinë Kolë Papparisto (2003): Bimët mjaltore të Shqipërisë		

Plani i dizajnuar i mësimet:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet

<i>Java e parë:</i>	Botanika farmaceutike emërtimi, përmbajtja dhe zhvillimi historik
<i>Java e dytë:</i>	Metodat e punës në botanikën farmaceutike
<i>Java e tretë:</i>	Vjelja e qëndrueshme e bimëve mjekësore dhe aromatike
<i>Java e katërt:</i>	Kalendari i vjeljes së bimëve mjekësore dhe aromatike
<i>Java e pestë:</i>	Trajtimi pas vjeljes i BMA dhe pemëve frutore të imta
<i>Java e gjashtë:</i>	Materiet aktive – vepruese që gjenden në lëngun qelizor dhe me gjerë
<i>Java e shtatë:</i>	Kollokviumi i parë
<i>Java e tetë:</i>	Disa Likene dhe fierna që hyjnë në kuadër të bimëve mjekësore
<i>Java e nëntë:</i>	Përshkrimi i bimëve mjekësore dhe aromatike nga grupi i Farëzhveshurave
<i>Java e dhjetë:</i>	BMA dhe Pemë frutore të imta nga grupi i Dikotiledoneve
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Lloje bimore mjekësore nga Familja Lamiaceae dhe Ericaceae
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Kolokfiumi i dytë
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Bimë mjekësore dhe aromatike tjera nga grupi i Dikotileve
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Vazhdim: Bimë mjekësore dhe aromatike nga grupi i Dikotileve
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Bimët mjekësore dhe aromatike nga grupi i Monokotileve
Java	Ushtrimi që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Rregullat e punës laboratorike me BMA
<i>Java e dytë:</i>	Rregullat teknike të përpunimit të BMA për treg
<i>Java e tretë:</i>	Përmbledhje e rregullave ndërkombëtare - diskutim
<i>Java e katërt:</i>	Llojet më të zakonshme të bimëve mjekësore në Kosovë
<i>Java e pestë:</i>	Origanum - llojet, karakteristikat morfologjike të gjinisë
<i>Java e gjashtë:</i>	Mentha - llojet dhe karakteristikat
<i>Java e shtatë:</i>	Salvia – llojet dhe karakteristikat
<i>Java e tetë:</i>	Rosaceae - llojet BMA dhe karakteristikat
<i>Java e nëntë:</i>	Lamiaceae - llojet BMA dhe karakteristikat
<i>Java e dhjetë:</i>	Asteraceae - llojet BMA dhe karakteristikat
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Llojet bimore të konsideruara mjekësore por që janë helmuese
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Helmueshmëria e BMA dhe kujdesi
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Identifikimi dhe krahasimi i mostrave të herbarizuara të llojeve të zgjedhura të BMA
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Identifikimi dhe krahasimi i mostrave të herbarizuara të llojeve të zgjedhura të BMA
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vizitë në një qndër grumbulluese dhe përpunuese të BMA

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentet duhet të jenë të rregullt në mësim, aktiv gjatë ligjëratave, të përgatiten, të jenë në gjendje të marrin te dhëna nga interneti, të bëjnë pyetje gjatë seancave mësimore. Duhet të mbajnë disiplinë, t'i shkyçin telefonat celular, të vijnë me kohë në ligjërata dhe terrene shkencore të organizuara nga profesori i lëndës në bashkëpunim me Departamentin e Biologjisë.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore, Departamenti i Biologjisë, Programi Biologji
Titulli i lëndës:	Biologji molekulare
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I/2
Numri i orëve në javë:	2 +2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc. Hazbije Sahiti, prof. asoc.
Detajet kontaktuese:	Tel. 044 41 33 11 hazbije.sahiti@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Biologjia molekulare ben studimin e sistemeve biologjike në nivel molekular. Biologjia molekulare merret me acidet nukleike dhe proteinat dhe si këto molekula bashkëveprojnë brenda qelizës për të nxitur rritjen, ndarjen dhe zhvillimin e duhur. Është një disiplinë e madhe dhe gjithnjë në ndryshim. Lenda perfshin: Metodrat ne biologjine molekulare, Natyren molekuare e gjeneve, Transkriptimin te prokariotet, Transkriptimin te eukariotet, Procesimin postranskripcional, Sintezen e proteinave dhe rregullimin gjenetik te organizmat e ndryshem
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> • Kursi Bazat e Biologjise Molekulare ka te beje me acidet nukleike dhe proteinat si dhe menyren se si keto molekula reagojne ndermjet veti per te ndihmuar ne menyre te sakte rritjen, ndarjen dhe zhvillimin e qelizes. • Gjate ketij kursi do te fokusohemi ne mekanizmat molekular te replikimit te ADN, riparimit, transkriptimit, sintezes se proetinave dhe rregullimin gjenetik te organizmat e ndryshem..
Rezultatet e pritura të nxënies:	Ne perfundim te ketij kursi studenti do te jete ne gjendje te: <ul style="list-style-type: none"> • Ne rastin e ndonje problemi te dhene nga fusha e biologjise molekulare te beje perzgjedhjen e duhur te teknikave eksperimentale, te beje perzgjedhjen e e teknikave adekuate ne rast te

	<p>izolimit dhe ndarjes se proteinave specifike dhe acideve nukleike.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Te pershkruaj mekanizmat e transkriptimit ADN dhe kontrollin e ketij procesi te te dy kategorit e organizmave (prokariot dhe eukariot). • Te shpjegoj modifikimet postranskriptive te qe ndodhin ne molekulat e ARN. • Te pershkuraj fazat e sintezes se proteinave. • Te interperetoj te dhenat nga artikujt e ndryshem shkencor. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokfiime,seminare	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	13	13
Përgatitja përfundimtare për provim	4	6	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	2	4
Projektet,prezantimet ,etj	2	2	4
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Ligjërata tradicionale, zbatimi i strategjive të mësimdhënies dhe të nxënit ndërveprues të cilat nxisin të menduarit konstruktiv përmes leximit dhe shkrimit, punës në grupe, diskutimit, të mësuarit përmes projekteve, zgjedhjes së problemeve, punës laboratorike dhe në terren si dhe prezantime audiovizuale me , videoprojektor, grafoskop, CD etj.</p>		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 30% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 7%</p>		

	Vijimi i rregullt 3% Provimi final 30% Total 100%
Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Beadini N., Beadini Sh. dhe Iseni G. – Biologji Molekulare. Tetove, 2007 2. Robert Weaver – Molecular biology. Mc Graw Hill, 2005
Literatura shpeshë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Matic G. – Osnovi Molekularne Biologije, 1997 2. Ariola Bacu. Praktika të Bioteknologjisë Molekulare. (Ribotuar) 2015. ISBN 978-99943-46-39-4 3. Panov S, Beadini N, Beadini Sh, Iseni G.: Praktikum i Biologjisë Molekulare. Tetovë, 2007 4. Keith Wilson, John Walker-Principles and Techniques of Biochemistry and Molecular Biology Publisher: Cambridge University Press 2010

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Objektivat e hulumtimit të Biologjisë Molekulare
Java e dytë:	Metodat e biologjisë molekulare
Java e tretë:	Natyra molekulare e gjeneve, ADN, ARN dhe proteinat
Java e katërt:	Gjenet, Gjenomat dhe ADN
Java e pestë:	Vlersimi i parë
Java e gjashtë:	Rregullimi i replikimit të ADN
Java e shtatë:	Transkriptimi i gjeneve
Java e tetë:	Rregullimi i transkriptimit të prokariotet
Java e nëntë:	Rregullimi i transkriptimit të eukariotet
Java e dhjetë:	Vlersimi i dytë
Java e njëmbëdhjetë:	Rregullimi në nivel të ARN
Java e dymbëdhjetë:	Procesimi i ARN

Java e trembëdhjetë:	Struktura dhe funksioni i proteinave, Sinteza e proteinave
Java e katërbëdhjetë:	Mutacionet
Java e pesëmbëdhjetë:	Rekombinimi dhe riparimi
Plani i disajnuar i mesimit – Ushtrime laboratorike:	
Java	Ushtrimet laboratorike qe do të mbahen
1.	Njohja me laboratorin e biologjisë molekulare, paisjet, funksionimi, qëllimet e përdorimit
2.	Ekstraktimi i ADN gjenomike nga indet bimore
3.	Matja e përqëndrimit dhe cilësisë së ADN gjenomike te ekstraktuar nga indet bimore
4.	Ekstraktimi i ADN gjenomike nga indet shtazore
5.	Matja e përqëndrimit dhe cilësisë së ADN gjenomike te ekstraktuar nga indet shtazore
6.	Ekstraktimi i ARN totale nga indet bimore
7.	Matja e përqëndrimit dhe cilësisë së ARN totale e te ekstraktuar nga indet bimore
8.	Ekstraktimi i proteinave totale nga inde bimore
9.	Matja e përqëndrimit dhe cilësisë te proteinave totale te ekstraktuar nga indet bimore
10.	Elektroforeza në xhel agaroze e poliakrilamidit te acideve nukleike
11.	Elektroforeza në xhel agaroze e poliakrilamidit te acideve nukleike
12.	PCR me site të përcaktuara
13.	Izolimi total i ADN së prej baktereve
14	Izolimi i ADN së së plazmideve
15.	Izolimi i ADN së prej gjakut

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimi si dhe mbajtja e qetësisë në mësim janë po ashtu të obligueshme.

SYLLABUS për lëndën: Biologjia e përgjithshme

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Universiteti i Prishtinës „ Hasan Prishtina” Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore Departamenti i Biologjisë Programi: Ekologji dhe mbrojtje mjedisit		
Titulli i lëndës:	Biologjia e përgjithshme		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	Viti i parë , semestri i parë		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:	Amfiteatri në Depart. e Fizikës		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Kasum Letaj Prof.asoc. dr. Hazbije Sahiti		
Detajet kontaktuese:	E-mail: kasum.letaj@uni-pr.edu hazbije.sahiti@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës			
	Në këtë lëndë përshkruhet struktura dhe funksioni i qelizave prokariote dhe eukariote, ndërtimi i organeleve qelizore dhe rolin e tyre në metabolizëm dhe energji. Vëmendje e posaçme do ti kushtohet ndërtimit dhe funksionit të indeve dhe organeve bimore dhe shtazore, zhvillimit embrional si dhe interaksioneve në mes botës së gjallë dhe mjedisit.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që studentët të fitojn njohuri mbi strukturën dhe funksionin e qelizave, të kuptojnë ndërtimin dhe rolin e organeleve qelizore në metabolizëm dhe energji. Po ashtu studenti do të kuptojë strukturën dhe funksionin e indeve dhe organeve bimore dhe shtazore si dhe zhvillimin embrional te bimët dhe shtazët.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studentët duhet të jenë në gjendje që të: <ol style="list-style-type: none"> 1. Njohin ndërtimin dhe funksionin e strukturave qelizore. 2. Analizojnë metabolizmin dhe qarkullimin e energjisë qelizore. 3. Përshkruajnë ndërtimin dhe funksionin e indeve dhe organeve bimore dhe shtazore. 4. Krahasojnë shumimin dhe zhvillimin embrional te bimët dhe shtazët. 5. Kuptojnë interaksionet në mes botës së gjallë dhe mjedisit. 		
Kontributi ne ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej

Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike		-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	6/semestër	-	6
Ushtrime në teren		-	-
Kollokfiime,seminare	4/semestër	-	4
Detyra të shtëpisë	6/semestër	-	6
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	6/semestër	-	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	4/semestër	-	4
Projektet,prezantimet ,etj	4/semestër	-	4
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ekspedita konsultime,projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuiume,provime.		
Metodat e vlerësimit:			
	Vlerësimi përfundimtar paraqet shumën: E punës së suksesshme praktike: 15% Vlerësimit të parë intermedier; 15% Vlerësimit të dytë intermedier:15% Vlerësimit të tretë intermedier:15% Vijimit të rregullt dhe angazhimit në diskutime dhe seminare 10% Provimit final me test ose me gojë: 30% Totali: 100 %		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Elezaj, R.I., Letaj, Rr. K.(2012): Biologjia qelizore. Universiteti I Prishtinës. Prishtinë. 2. Haqif Q. (2002): Biokimia Universiteti i Prishtinës. Prishtinë. 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dervish Rozhaja. Fiziologjia krahasuese. Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës, 2002, Prishtinë. 2. Kennet.M., Jonathan, L., Susan, S.: Biology, nain edition. 3. Carol, F., Wiliam, K.(2004):Byology an exploration of life. First edition. ISBN 0-393-95716-0 		
Plani i dizajnuar i mësimimit:			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		
Java e parë:	Kimia e jetës.		

Java e dytë:	Struktura dhe funksioni i qelizës; Krahasimi ne mes qelizave prokariote dhe eukariote; Struktura e membranës qelizore dhe transporti.
Java e tretë:	Kompartimentet (organelet) brenda qelizore dhe citoskelti
Java e katërt:	Cikli qelizor <ul style="list-style-type: none"> • Mitoza • Mejoza • Kontrolli i ciklit qelizor
Java e pestë:	Metabolizmi i karbohidrateve
Java e gjashtë:	Metabolizmi i lipideve
Java e shtatë:	Metabolizmi i proteinave
Java e tetë:	Fosforilimi oksidues.
	Vlerësimi i parë intermedier
Java e nëntë:	Shumimi te bimët; Indet dhe organet bimore; Morfologjia e organeve vegjetative; Ndërtimi i lules.
Java e dhjetë:	Struktura dhe funksioni i indeve shtazore.
Java e njëmbëdhjetë:	Shumimi dhe zhvillimi embrional te shtazët.
Java e dymbëdhjetë:	Morfologjia dhe fiziologjia e sistemeve të organeve te shtazët <ul style="list-style-type: none"> • Sistemi i organeve te tretjes • Sistemi i qarkullimit te gjakut • Sistemi i organeve te frymëmarrjes
	Vlerësimi i dytë intermedier
Java e trembëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> • Sistemi i organeve për sekretim • Sistemi muskolor skeletor • Sistemi nervor
Java e katërmëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> • Organet shqisore • Sistemi endokrin • Sistemi imun
Java e pesëmbëdhjetë:	Interaksioni në mes botës së gjallë dhe mjedisit.
	Vlerësimi i tretë intermedier
Plani i dizajnuar i mësimit– Ushtrimet:	
Nr.	Ushtrimet laboratorike që do të zhvillohen
1.	Mikroskopi dhe mikroskopimi
2.	Ndërtimi i qelizës prokariote.
3.	Ndërtimi i qelizës eukariote.
4.	Mitoza dhe Mejoza
5.	Reaksionet e identifikimit te karbohidrateve
6.	Përcaktimi sasior i karbohidrateve ne serum me metodën spektrofometrike
7.	Reaksionet e identifikimit te proteinave dhe aminoacideve
8.	Përcaktimi sasior i proteinave te indet bimore dhe shtazore me metodën spektrofotometrike
9.	Përcaktimi sasior i lipideve ne serum me metodën spektrofometrike
10.	Indet shtazore
11.	Gametogjeneza
12.	Zhvillimi embrional te iriqi i detit; Zhvillimi embrional i amfibeve; formimi i hapësirës amniotike te shpezët.
13	Ventilacioni i mushkërive

14	Sistemi i qarkullimit te gjakut te bretkosa
15	Organet e brendshme te bretkosa

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive e studentëve në ligjërata, ushtrime (pjesën praktike) dhe se punë seminarike; Mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja me kohë në sallë të mësim, etj..

SYLLABUS për lëndën: Biomonitorim

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Universiteti i Prishtinës „ Hasan Prishtina” Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore Departamenti i Biologjisë Drejtimi: Ekologji dhe mbrojtje e mjedisit		
Titulli i lëndës:	Biomonitorim		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	Viti i dytë , semestri i tretë		
Numri i orëve në javë:	2+2		
Vlera në kredi – ECTS:			
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr.. Kemajl Kurteshi		
Detajet kontaktuese:	kemajl.kurteshi@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës	Në këtë lëndë përshkruhet biomonitorimi, rëndësia dhe objektivat, tipet biomonitorimit si dhe organizmat indikatorë. Po ashtu do të përshkruhet mënyra e vlerësimit të ndotjes përmes monitorimit të larmisë biologjike dhe bioindikatorëve.		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi kryesor i kësaj lënde është që studentët t'i njohë me metodat e biomonitorimit të mjedisit, organizmat indikatorë dhe biomarkerët. Po ashtu studentet do të kenë mundësi të vlerësojnë shkallën e ndotjes përmes bioakumulimit .		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jetë në gjendje që: 1. Të njihen me metoda e biomonitorit të mjedisit. 2. Të kuptojnë: tipet biomonitorimit mjedisor, organizmat indikatorë, biomarkerët dhe bioakumulimin. 3. Të aplikojnë metodat e përshtatshme për biomonitorimin e mjedisit 4. Të vlerësojnë mbi ndotjen e mjedisit. 5. Të zbatojnë njohuritë teorike në praktike.		
Kontributi ne ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Kontributi ne ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti	Aktiviteti
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			

Punë praktike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Ushtrime në teren	4	2 dite	8
Kollokfiume,seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	2	5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	10	20
Përgatitja përfundimtare për provim	3	6	18
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	1	2	2
Projektet,prezantimet ,etj	1	2	2
Total			126
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ekspedita konsultime,projekte të pavarura, detyra shtëpie, kolokviume,provime.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi përfundimtar paraqet shumën: E punës së suksesshme praktike: 25% Vlerësimit të parë intermedier; 15% Vlerësimit të dytë intermedier:20% Vijimit të rregullt dhe angazhimit në diskutime dhe seminare 10% Provimit final me test ose me gojë: 30% Totali: 100 %		
Literatura			
Literatura bazë:	Skripta e perpiluar nga Kemajl Kurteshi		
Literatura shtesë:	1. B.A. Markert, A.M. Breure, H.G. Zechmeister. Bioindicators& Biomonitors, 2003. 2. Enrico Bergamaschi, Irina Guseva Canu, Adriele Prina-Mello, Andrea Magrini. Biomonitoring, 2015 3. M.E. Conti. Biological Monitoring:Theory and Applications—Bioindicators and Biomarkers for Environmental Quality and Human Exposure Assessment . 2008 4.Aleko Miho: Monitorimi biologjik Mjedisor. Tiranë. 2011		
Plani i dizajnuar i mësimi:			
Java	Ligjërata që do të zhvillohet		

Java e parë:	Biomonitorimi, rëndësia dhe objektivat.
Java e dytë:	Zonat biomonitoruese
Java e tretë:	Indeksat (Treguesit) e biomonitorimit
Java e katërt:	Tipet biomonitorimit dhe efikasiteti i tyre
Java e pestë:	Organizmat indikatorë
Java e gjashtë:	Vlerësimi i cilësive biologjike të mjedisit
Java e shtatë:	Klasifikimi ekologjik i tokës
	Vlerësimi i parë intermedier
Java e tetë:	Integriteti biologjik
Java e nëntë:	Vlerësimi i ndotjes
Java e dhjetë:	Monitorimi i larmisë biologjike
Java e njëmbëdhjetë:	Biosfera, saprotrofizmi, rrjedha energjise
Java e dymbëdhjetë:	Organizmat indikator
Java e trembëdhjetë:	Metodat , matricat e monitorimit
Java e katërbëdhjetë:	Bioakumulimi. biokoncentrimi, biomagnifikimi , mutageneza
Java e pesëmbëdhjetë:	Mutagjenet dhe kancerogjenet
	Vlerësimi i dytë intermedier
Plani i dizajnuar i mësimit– Ushtrimet:	
Nr.	Ushtrimet laboratorike që do të zhvillohen
1.	Monitorimi përmes përcaktimit të parametrave fizik të ujit
2.	Monitorimi përmes përcaktimit të parametrave kimik të ujit
3.	Monitorimi i ujit të ndotur përmes pranisë së jo vertebrorëve
4.	Monitorimi i ujit të ndotur përmes algave Nostoc
5.	Monitorimi i ujit të ndotur përmes algave të gjelbra. Indeksi i Palmer-it për ndotje organike
6.	Monitorimi i ajrit përmes indikatorëve bimorë
7.	Efekti i pesticideve në parametrat biokimik të plazmës së gjakut në organizmat shtazorë
8.	Efekti i ndotësve në sintezën e proteinave; Përcaktimi i proteinave totale
9.	Bioakumulimi i metaleve të rënda në organet e cakt.
10.	Ndikimi i metaleve të rënda në aktivitetin e enzimave të stresit oksidativ
11.	Aktiviteti i alanin dhe aspartat transaminazës në plazmën e gjakut
12.	Monitorimi I ndotjes së mjedisit përmes parametrave hematologjik
13.	Efekti i Pb në histologjinë e indeve
14.	Analizimi dhe interpretimi i të dhënave
15.	Monitorimi përmes parametrave morfometrik.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive e studentëve në ligjërata, ushtrime (pjesën praktike) dhe se punë seminarike; Mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja me kohë në sallë të mësimit etj..	

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore, Departamenti i Biologjisë, Programi Ekologji dhe Mbrojtje e mjedisit
Titulli i lëndës:	Bioteknologji mjedisore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	III/5
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc. Hazbije Sahiti, prof. asoc.
Detajet kontaktuese:	Tel. +386 44 413 311 hazbije.sahiti@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Kursi është një hyrje në bioteknologjinë mjedisore dhe fokusohet në përdorimin e proceseve mikrobiale në trajtimin e mbeturinave dhe ujërave, si dhe bioremediim. Temat e përfshira janë metabolizmi i energjisë mikrobike, kinetika e rritjes mikrobike dhe teoria elementare e kimiostatit, proceset përkatëse mikrobiologjike, ekologjia mikrobiale, qasjet për studimin e komuniteteve mikrobike dhe parimet bazë në bioremediimin dhe trajtimin biologjik të ujit dhe mbeturinave.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Kursi i Bioteknologjisë Mjedisore synon të prezantojë dhe shtjellojë konceptet dhe aplikimet themelore të bioteknologjisë në të gjitha aspektet e mjedisit, duke përfshirë mbrojtjen, restaurimin dhe qëndrueshmërinë e tij. Duke marrë parasysh sfidat në rritje të ndryshimeve klimatike, energjisë dhe krizës mjedisore, ky kurs do të ketë theks te vecante zhvillimet e fundit të bioteknologjisë për shfrytëzimin e potencialit mikrobial në aplikimet mjedisore; do të ofrojë baza të shëndosha teknike për përdorimin e bioteknologjisë në zgjidhjen e çështjeve mjedisore dhe pastrimin e mjedisëve të ndotura.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Në përfundim të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none">• Të kuptojë dhe të përvetësojë konceptet dhe terminologjinë specifike të bioteknologjisë mjedisore.• Te gjej dhe te menaxhoje informacione nga burime të ndryshme.

	<ul style="list-style-type: none"> • Te përshkruaj bazat shkencore që zbatohen nga bioteknologjia mjedisore. • Te përshkruaj vetitë e mikroorganizmave me aplikim të mundshëm në proceset bioteknologjike mjedisore. • Të shpjegojë teknologjitë, mjetet dhe teknikat në fushën e bioteknologjisë mjedisore. • Të njohë rolin e mikroorganizmave si agjentë bioteknologjikë. • Të zotërojë terminologjinë bazë të biologjisë molekulare dhe gjenetikës. • Te studioje bioreaktorët për aplikim mjedisor.
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	-	-	-
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	3	6
Projektet,prezentimet ,etj	1	4	4
Totali	13		140

Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata tradicionale, zbatimi i strategjive të mësimdhënies dhe të nxënit ndërveprues të cilat nxisin të menduarit konstruktiv përmes leximit dhe shkrimit, punës në grupe, diskutimit, të mësuarit përmes projekteve, zgjedhjes së problemeve, punës laboratorike dhe në terren si dhe prezantime audiovizuale me ,
-------------------------------------	--

	videoprojektor, grafoskop, CD etj.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 30% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 7% Vijimi i rregullt 3% Provimi final 30% Total 100%
Literatura	
Literatura bazë:	1. Environmental Biotechnology: Theory and Application, Gareth G. Evans, Judy Furlong, Wiley Blackwell, 2011
Literatura shtesë:	1. Environmental Biotechnology: Concepts and Applications, Hans- Joachim, J. and Josef, W. (ed.) Wiley-VCH Verlag, Germany, 2005

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Bioteknologjia dhe Qëndrueshmëria Mjedisore. Fushëveprimi dhe aplikimet e subjektit. Bazat e strukturës dhe funksionit të ekosistemit.
Java e dytë:	Ekologjia mikrobike dhe Bioteknologjia Mjedisore: Konceptet dhe rëndësia e ekologjisë mikrobike në Bioteknologjinë Mjedisore.
Java e tretë:	Mikrobiologjia e Sistemit Inxhinierik të Mjedisit: Diversiteti mikrobik, rritja dhe kalbja. Stoikiometria e energjisë dhe kinetikës mikrobike.
Java e katërt:	Shfrytëzimi i burimeve nga mikroorganizmat: Funksionet e grupeve perkatese te mikrobeve të ndryshme për sistemet mjedisore, duke përfshirë trajtimin e mbetjeve dhe rikuperimin e burimeve, implikimet në biogjeokimi.
Java e pestë:	Vlersimi i pare
Java e gjashtë:	Metodat në Ekologjinë Mikrobike që lidhen me Bioteknologjinë Mjedisore:

	Analiza të varura dhe të pavarura nga kultura e komuniteteve mikrobike; Metodat e bazuara në PCR, Microarray, Gjenomika e mjedisit.
Java e shtatë:	Parimet Mikrobiale të Biodegradimit, Biodetoksifikimit dhe procese të tjera të rëndësishme për Aplikimet Mjedisore: Motorët mikrobikë, (metabolizmi).
Java e tetë:	Teknologjitë e Bioremediimit: Konceptet, metodat dhe aplikimet e dobësimit natyror dhe bioremediimi inxhinierik.
Java e nëntë:	Ndërveprimet mikrobike me metalet e rënda dhe metaloidet: Bioremediimi, Biojidrometalurgjia dhe aspekte të tjera të Bioteknologjisë Mjedisore.
Java e dhjetë:	Vlersimi i dyte
Java e njëmbëdhjetë:	Degradimi aerobik dhe anaerobik i komponimeve alifatike dhe aromatike. Ndërveprimi mikrobik me plastikën, antibiotikët dhe ndotës të tjerë të shfaqura.
Java e dymbëdhjetë:	Largimi i fosforit dhe azotit i rritur mikrobialisht
Java e trembëdhjetë:	Rikuperimi i vajit të zhvilluar në mënyrë mikrobike. Roli mikrobik në deponimin dhe kapjen e karbonit.
Java e katërbëdhjetë:	Raste studimore: Bioremediimi, Deponimi dhe Kapja e Karbonit, Bioenergji.
Java e pesëmbëdhjetë:	Permbledhje e njesive të zhvilluara

Plani i dizajnuar i mesimit – Ushtrime laboratorike:

Java	Ushtrimet laboratorike që do të mbahen
1.	Grumbullimi, përpunimi dhe ruajtja e mostrave efluate
2.	Përcaktimi i kërkesës kimike të oksigjenit në mostrat e ujërave të zeza
3.	Përcaktimi i oksigjenit të tretur në mostrat e ujërave të zeza
4.	Përcaktimi lëndëve të ngurta totale të tretura në mostrat e ujërave të zeza
5.	Analiza e ngurtësisë totale të mostrave së ujërave të zeza
6.	Analiza e ngurtësisë së përkohshme të mostrës së ujërave të zeza
7.	Analiza e e metaleve të rënda në ujërat e zeza/llum
8.	Përcaktimi i nivelit të zërit duke përdorur matësin e nivelit të zërit
9.	Vlerësimi i Abundancës Llojore të Bimëve
10.	Vlerësimi i pluhurit jo të thithshëm në ajër duke përdorur Dust Sampler

11.	Vlerësimi i pluhurit të thithshëm në ajër duke përdorur Dust Sampler
12.	Vizitë në Impiantin e Trajtimit të ujërave të Zeza në Prizren
13.	Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit në shkencën e mjedisit
14	Vizitë në një zonë të ndotur lokale - Vëzhgimet dhe Masat Përmirësuese
15.	Vizitë në Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit si dhe mbajtja e qetësisë në mësim janë po ashtu të obligueshme.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN
Titulli i lëndës:	Botanikë
Niveli:	3 vjeçar (Bachelor)/Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	I
Numri i orëve në javë:	2+2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	FSHMN-Departamenti i Biologjisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Elez Krasniqi
Detajet kontaktuese:	+383 49 209 100 +383 44 209 100 elez.krasniqi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Lënda Botanikë ofron njohuri lidhur me karakteristikat anatomike dhe morfologjike të bimëve, principet e sistematizimit të bimëve dhe për grupet kryesore të bimëve. Në vazhdimësi studentëve u ofrohet njohuri për bimët duke përdorur edhe shembuj nga bimët e Kosovës.
Qëllimet e lëndës:	Kursi i ofruar do ju mundësoj studentëve që: <ol style="list-style-type: none">1. të fitojnë njohuri lidhur me rolin e bimëve në mjedis2. të njohin historikun e botanikës3. të fitojnë njohuri bazike për anatominë, morfologjinë dhe për sistematikën e bimëve4. të kuptojnë ndërtimin e qelizës, ndërtimin anatomik dhe morfologjik të bimëve si dhe shumëzimin e bimëve5. të fitojnë njohuri duke aplikuar klasifikimin e bimëve
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kësaj lënde (kursit) studentët do të jenë në gjendje që: <ol style="list-style-type: none">1. të shpjegojnë ndërtimin anatomik dhe morfologjik të organeve bimore, rolin e bimëve, dhe klasifikimin e tyre2. të fitojnë njohuri mbi familjet kryesore të bimëve vaskulare3. të aplikojnë fjalorin bazë të anatomisë dhe morfologjisë së bimëve që do të ju ndihmoj atyre që të kuptojnë evolucionin e karaktereve morfologjike të bimëve vaskulare

	<ol style="list-style-type: none"> 4. të identifikojnë një numër të konsiderueshëm të llojeve bimore nga flora e Kosovës. 5. të përdorin çelësin dikotomik për identifikimin e bimëve nga materiali i freskët dhe i herbarizuar 6. të aplikojnë herbarizimin e bimëve 7. të implementojnë njohuritë dhe shkathhtësitë e fituara nga lëmi i botanikës në hulumtime dhe projekte të ndryshme 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	1/15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	1/15	30
Punë praktike	1	1/15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/7	7
Ushtrime në terren	2	1/2	4
Kollokfiume, seminare	2	1/2	4
Detyra të shtëpisë	2	1/5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	1/15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	1/5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1/3	6
Projektet,prezentimet, etj	2	1/2	4
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime, punë praktike në terren, konsultime, Seminare, detyra shtëpie, vlerësime, provime.		
Metodat e vlerësimit:	<p style="text-align: center;">Vlerësimi në praktikë dhe në teori</p> Vlerësimi: Vlerësimi i parë deri 30 % Vlerësimi i dytë deri 30 % Vijimi dhe detyrat deri 10 % Provimi final deri 30 % Totali 100 %		
Literatura			

Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> • Rexhepi, F. (2000): Botanika I. UP-FSHMN. Prishtinë. • Rexhepi, F. (1999): Botanika II. UP-FSHMN. Prishtinë. • Millaku, F. (2015): Praktikum i botanikës së përgjithshme. Universiteti Haxhi Zeka. Pejë.
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • Sherifi, E. (2001): Anatomia dhe morfologjia e bimëve. UP-FSHMN. Prishtinë. • Krasniqi, F. (1985): Sistematika e bimëve të larta me elementet e filogjenisë. UP-FSHMN. ETMM. Prishtinë. • Pajazitaj, Q. (2017): Përcaktues i bimëve. UP-FSHMN. Prishtinë. • Nikolic, T. (2017): Morfologjia biljaka. Uzbenici Sveucelista u Zagrebu. Nakladnik ALFA d.d. Zagreb. • Nikolic, T. (2013): Sistematska botanika. Uzbenici Sveucelista u Zagrebu. Nakladnik ALFA d.d. Zagreb. • Nikolic, T. (2013): Praktikum sistematske botanike. Uzbenici Sveucelista u Zagrebu. Nakladnik ALFA d.d. Zagreb. • Simpson, MG. (2006): Plant Systematics. Elsevier Inc, Burlington MA. • Simpson, MG. (2013): Plant Systematics Laboratory Manual, San Diego.

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje, rëndësia e bimëve, degët e botanikës
<i>Java e dytë:</i>	Qeliza bimore, forma, madhësia dhe organelet e saj
<i>Java e tretë:</i>	Indet bimore
<i>Java e katërt:</i>	Organet bimore
<i>Java e pestë:</i>	Shumëzimi i bimëve
<i>Java e gjashtë:</i>	Hyrje në sistematikën e bimëve
<i>Java e shtatë:</i>	Vlerësimi i parë
<i>Java e tetë:</i>	<i>Bryophyta</i>
<i>Java e nëntë:</i>	<i>Pteridophyta</i>
<i>Java e dhjetë:</i>	<i>Pinophyta</i>
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<i>Magnoliophyta</i> (Kl. <i>Magnoliopsida</i> -Nënkl.: <i>Magnoliidae</i> - <i>Hamamelididae</i>)
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<i>Magnoliophyta</i> (Kl. <i>Magnoliopsida</i> -Nënkl.: <i>Caryophyllidae</i> - <i>Dilleniidae</i>)
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<i>Magnoliophyta</i> (Kl. <i>Magnoliopsida</i> -Nënkl.: <i>Rosidae</i> - <i>Asteridae</i>)
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	<i>Magnoliophyta</i> (Kl. <i>Liliopsida</i>)
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i dytë
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ushtrimet që do të zhvillohen
<i>Java e parë:</i>	Mikroskopi dhe vrojtimi i qelizave bimore
<i>Java e dytë:</i>	Aparati gojëzor dhe plastidet
<i>Java e tretë:</i>	Amidoni, aleuronat dhe kristalet
<i>Java e katërt:</i>	Muri qelizor
<i>Java e pestë:</i>	Indet meristematike
<i>Java e gjashtë:</i>	Indet mbrojtëse
<i>Java e shtatë:</i>	Ndërtimi anatomik i organeve vegetative Vlerësimi i parë
<i>Java e tetë:</i>	Ndërtimi anatomik i organeve vegetative-vazhdim
<i>Java e nëntë:</i>	Organet riprodhuese të bimëve
<i>Java e dhjetë:</i>	Gjethet, lulet, lulesat, frutet
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Determinim i bimëve (<i>Bryophyta</i> dhe <i>Pteridophyta</i>)
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Determinim i bimëve (<i>Pinophyta</i>)
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Determinim i bimëve (<i>Magnoliophyta</i> - <i>Magnoliopsida</i>)
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Determinim i bimëve (<i>Magnoliophyta</i> - <i>Liliopsida</i>)
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Udhëzime për përgatitjen e herbarit Vlerësimi i dytë

Gjatë punës praktike në terren nga studentët do të përgatitet herbari.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Studentët duhet të jenë të rregullt në mësim, aktiv gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, të përgatiten, të jenë në gjendje të marrin te dhëna nga interneti, të bëjnë pyetje gjatë seancave mësimore. Duhet të mbajnë disiplinë, t'i shkyçin telefonat celular, të vijnë me kohë në ligjëratat dhe në

ushtrime dhe mos të pengojnë mbarëvajtjen e mësimet.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore Departamenti i Biologjisë Drejtimi: Ekologji - Mbrojtje e Mjedisit
Titulli i lëndës:	Burimet e Bioenergjisë, Sistemet dhe Efektet Mjedisore
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti III, semestri V
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Departamenti i Biologjisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc. Kemajl Kurteshi, prof. i rreg.
Detajet kontaktuese:	E-mail: kemajl.kurteshi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Ky modul “Burimet e Bioenergjisë, Sistemet dhe Efektet Mjedisore” ofron një hyrje të detajuar për përdorimin e biomasës në prodhimin e bioenergjisë dhe përfshin një rishikim të gjerë të burimeve të biomasës, sistemeve të përpunimit, efekteve negative në shëndetin e njeriut, dëmtimin e mundshëm mjedisor, zvogëlimin e ndotjes, sistemet gjeneruese të energjisë dhe efektet e përgjithshme të përdorimit të burimeve të rinovueshme dhe jo- te rinovueshme.</p> <p>Një vend të rëndësishëm zë shfrytëzimi i biomasës nga lëndët djegëse, shpjegimet dhe diskutimet mbi sfondin, rëndësinë, njohuritë themelore dhe hulumtimet aktuale, duke përfshirë studimet e rasteve, të teknologjive të energjisë së rinovueshme në forma të ndryshme si energjia nga uji, era, burimet gjeo-termike dhe lëndët djegëse të biomasës. Fokusimi në rolet e teknologjisë së pastër, riciklimin e mbeturinave dhe reduktimin e kostos së energjisë për mjedis të qëndrueshëm.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Njohja me praktikat Botërore dhe të vendit tonë për përdorimin e biomasës.</p> <p>Tematika e lëndës ndihmon në formimin e koncepteve kryesore mbi energjinë dhe biomasën, konsolidimin e koncepteve mbi energjitë e rinovueshme, impaktin në mjedis dhe masat që mund të merren për parandalimin e</p>

	<p>tyre.</p> <p>Lënda ka si synim transmetimin tek studentët edhe të teknikave bashkëkohore të përpunimit të të gjithë materialeve organikë, përfshirë biomasën, sidomos tani kur kriza energjetike për burime të lëndëve të djegshme fosile është më se aktuale.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Parimet që bazohen në projektimin dhe funksionimin e mbeturinave dhe biomasës në sistemet e energjisë. • Sqarimin në përgjithësi të burimeve kryesore të energjisë dhe aplikacionet e tyre primare në vend dhe botë. • Të jetë i vetëdijshëm për nënproduktet e padëshiruara të djegies së mbeturinave biomasës, pirolizës dhe gazifikimit. • Të jenë të vetëdijshëm për teknikat dhe kufizimet e ashpërsimit të gazrave të zjarrit dhe ripërdorimin / riciklimin e hirit (që lidhen me industrinë e mbetjeve / biomasa). • Të jenë në gjendje të krahasojnë opsionet e hedhjes së mbetjeve termike me metoda të tjera të deponimit (p.sh. deponimi, kompostoja AD, autoklava etj.). • Të njohin metodologjitë aktuale të hulumtimit në trajtimin termik të mbeturinave dhe biomasës.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	5	10
Ushtrime në teren	1	15	15
Kollokfiume,seminare	2	5	10
Detyra të shtëpisë	2	5	10

Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	5	10
Projektet,prezentimet ,etj	2	5	10
Totali			150

Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime, punë praktike në laborator dhe terren, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokviume, provime.
Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> ➤ Vlerësimi pas kollokviumit të parë 25% ➤ Vlerësimi pasë kollokviumit të dytë 25% ➤ Puna laboratorike 15% ➤ Vijimi i rregullt 5% ➤ Provimi final 30% ➤ Total 100%.

Literatura	
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Cheng, J.J. (2009) Biomass to Renewable Energy Processes. CRC Press/Taylor & Francis Group, Boca Raton, Florida, USA. ISBN: 9781420095173. 2. Godfrey Boyle, “Renewable Energy, Power for a sustainable future” third edition, Oxford University Press, 2012, ISBN: 978-0199545339
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 3. Basu, P. 2013. Biomass Gasification, Pyrolysis and Torrefaction: Practical Design and Theory. Published by Elsevier Inc. ISBN: 978-0-012-396488-5. 4. Brown, R.C., Brown, T.R: (2013) Biorenewable Resources: Engineering New Products from Agriculture, 2nd Edition. Wiley. ISBN: 9781118524930

Plani i dizejnuar i mësimi: Ligjëratat

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Konceptet bazë mbi energjinë dhe biomasën si burim i rinovueshëm energjetik.
Java e dytë:	Biomasa dhe bio-energja: Llojet e biomasës dhe teknologjitë e konvertimit në prodhimin e bio-karburantit.
Java e tretë:	Reaksionet enzimatike dhe bio-proceset mikrobiologjike. Metabolizmi dhe rrugët.
Java e katërt:	Tretja Anaerobe: Mikroorganizmat anaerobike. Procesi i prodhimit të metanit, hidrogjenit dhe bioetanolit:
Java e pestë:	Biomasa nga mbetjet urbane, industriale, agro-bujqësore si vlerë materiale dhe energjetike.
Java e gjashtë:	Avantazhet dhe disavantazhet e drurit, kulturave bujqësore, mbeturinave komunale, deponive etj. Si lëndë djegëse të biomasës.
Java e shtatë:	Formimi i naftës dhe qymyreve, skenarët organikë të origjinës së tyre.
Java e tetë:	Transformimi i biomasës në biokarburant: konvertimi termokimik, fermentimi i singës. <i>Vlerësimi i parë intermediar.</i>
Java e nëntë:	Metoda dhe procese të ekstraktimit. Ekstraktimi i lëndëve energjetike, vajore dhe të tjera nga biomasa.
Java e dhjetë:	Bimët energjetike. Reduktimi i efektit serrë, mbyllja e ciklit.
Java e njëmbëdhjetë:	Prodhimi i bionaftës nga vajrat e farave, vajrat e mbeturinave dhe algat.
Java e dymbëdhjetë:	Çështjet e ndotjes dhe mjedisit në lidhje me burimet e përbashkëta të energjisë.
Java e trembëdhjetë:	Matja e vlerave të energjisë dhe parametrave përkatës.
Java e katërbëdhjetë:	Trendet në shfrytëzimin e energjisë nga biomasa. Energjia geotermale, modelet financiare, legjislacioni, procedurat administrative.
Java e pesëmbëdhjetë:	Kufizimet në përdorimin e biokarburanteve për shkak të shqetësimeve të shëndetit të njeriut dhe shqetësimeve mjedisore. <i>Vlerësimi i dytë intermediar.</i>
Plani i dizajnuar i mësimit: Ushtrimet	
Java	
Java e parë:	Nocione të përgjithshme për energjinë dhe biomasën.
Java e dytë:	Burimet bioenergjetike dhe potenciali energjetik i tyre.
Java e tretë:	Proqeset e para përpunimit të biomasës: tharje, zvogëlim i madhësisë dhe densifikimi.
Java e katërt:	Vlerat energjetike në varësi të përmbajtjes elementare të lëndëve energjetike (rasti i raportit C/H ₂).

<i>Java e pestë:</i>	Vlerësimi i burimeve energjetike në përgjithësi dhe atyre të biomasës në veçanti mbi bazën e konceptit të lëndëve djegëse konvencionale.
<i>Java e gjashtë:</i>	Vlerësimi energjetik i biomasës në mbetjet urbane të një qyteti.
<i>Java e shtatë:</i>	Vlerësimi për rritjen Q nga tharja natyrore e biomasës.
<i>Java e tetë:</i>	Përgatitja e një laboratorit për qymyr aktiv.
<i>Java e nëntë:</i>	Biokimia e biomasës. Proceset e trajtimit të saj.
<i>Java e dhjetë:</i>	Biokarburantet me vajra vegjetal.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Demonstrim laboratorik i proceseve termike në biomasë.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Materialet ekologjike mjedisor nga biomasa.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Trajtimi i mbetjeve nga biomasa. Biobriketat.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Ekstraktimi i lëndëve energjetike, vajore dhe të tjera nga biomasa.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Teknologjia e gatitjes së biodiezelit.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Shkycja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit si dhe mbajtja e qetësisë në mësime janë po ashtu të obligueshme.

Forma e syllabusit të lëndës

Të dhënat bazike të kursit	
Njësia akademike:	Fakulteti I shkencave Matematike-Natyrore Departamenti I Biologjisë Ekologji dhe mbrojtje e mjedisit
Emërtimi i lëndës:	Ekologjia e mjediseve të ndotura
Niveli:	Bachelor (Bsc)
Statusi I lëndës:	Zgjedhore
Viti I studimeve/Semestri:	Viti i II-të, semestri III
Numri I orëve në javë	2+2
Vlera e kredive – ECTS:	6
Koha / vendi:	E enjte, 11.30-13.00, Sall C
Ligjërues:	Dr.sc. Agim Gashi
Kontakti:	044113819, agim.gashi@uni-pr.edu
Përshkrimi I lëndës	<p>Kjo lëndë ka të bëjë me konceptet e zhvillimit historik të popullatës humane dhe ndikimet në natyrë, ndotjen e mjedist, prodhimin e ushqimit dhe kapacitetet e mjedisit, pestët dhe pesticidët, problemet urbane, rreziqet mjedisore dhe shendetin e njeriut, rëndësinë e biodiversitetit dhe biomonitorimin.</p>
Qëllimi I lëndës:	<p>Qëllimi i kursit Ekologjia e mjediseve të ndotura është zhvillimi i njohurive mbi mjediset e ndotura dhe mbrojtjen e tyre, ndikimi i aktiviteteve njerëzore në natyrë dhe mënyrat e restaurimit të ekosistemeve të ndryshme.</p>
Rezultatet e të nxënit:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none">• përshkruajnë kuptimin e termave, fakteve dhe koncepteve që lidhen me ndotjen natyrore dhe antropogjene të mjedisit• Analizojnë ndikimin e ndotësve në ekosisteme të ndryshme• Vlerësojnë ndikimet e ndotjes së mjedisit në organizmat e gjallë dhe degradimin e ekosistemeve• Zhvillojnë të menduarit kritik në kontekstin e zgjidhjes së problemeve që lidhen me mjedisin duke zbatuar njohuritë ekologjike.• Analizojnë degradimin dhe çrregullimin e ekuilibrit ekologjik në ekosisteme.

	<ul style="list-style-type: none"> • Përshkruajnë metodat e biomonitorimit të mjediseve të ndotura. • Parashikojnë pasojat e ndotjes së mjediseve të ndryshme jetësore në sistemet e gjalla. 		
Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokfiume,seminare	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	13	13
Përgatitja përfundimtare për provim	4	6	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	2	4
Projektet,prezantimet ,etj	2	2	4
			150
Metodat e mësimdhënies	Metodologjia e mësimdhënies bazohet në: leksione, ushtrime, seminare dhe debate, konsultime, detyra të pavarura, punë në shtëpi, kolokviume, provime.		
Evaluation methods	Vlerësimi i parë itermedier: 25% Vlerësimi idytë itermedier 25% Detyrat e shtëpisë dhe semianret: 10% Vijueshmëria e rregullt: 5% Provimi final: 35% Totali 100%		
Literatura:			
Literatura thmelore:	1. W. P. Cunningham &M.A. Cunningham (2008): Principles of Environmental Sciences. McGraw- Hill		
Literatura shtesë:	1. W. P. Cunningham & B.W. Saigo (1997): Environmental Science, a global concern. WCB/McGraww-Hill. USA 2. B. J. Nebel & R.T. Wright (2002): Environmental Science .Prentice Hall.Englewood Cliffs, New Jersey. USA 3. Agim Gashi, Fetah Halili, Halil Ibrahimimi (2007) Ekologjia e Mjediseve të Ndotura, Prishtinë 4. L.K. Singh (2008) Ecology, Environment and Tourism, Isha Books, India		

--	--

Plani mësimor – Ligjërata:	
Java	Ligjëratat që do të mbahen:
<i>Java e parë:</i>	Zhvillimi historik I shoqërive njerëzore dhe ndikimi në natyrë
<i>Java e dytë:</i>	Përkufizimi I konceptit “Njeriu dhe mjedisi jetësorë”
<i>Java e tretë:</i>	Tipet e mjediseve jetësore
<i>Java e katërt:</i>	Ndotja e ajrit dhe ndikimi në ekosisteme
<i>Java e pestë:</i>	Ndotja e tokës-dheut dhe ndikimi në ekosisteme
<i>Java e gjashtë:</i>	Ndotja radioaktive
<i>Java e shtatë:</i>	Ndotja e ujit dhe ndikimi në ekosisteme
<i>Java e tetë:</i>	Prodhimtaria dhe ndotja Vlerësimi i parë intermedier
<i>Java e nëntë:</i>	Pestët dhe pesticidet
<i>Java e dhjetë:</i>	Qyteti si ekosistem dhe problemet urbane
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Ruajtja dhe mbrojtja e biodiversitetit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Biomonitorimi i ekosistemeve të ndotura
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Rreziqet e mjedist dhe shëndeti i njeriut
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Ndotja dhe mbrojtja e ekosistemeve në ekosistemet detare
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Ndotja e mjedisit në Kosovë Vlerësimi i dytë intermedier

Ushtrimet – pune seminarike
Në kuadër të ushtrimeve studentët do të kryejnë punën seminarike ku do të përfshihen tema të ndryshme që kanë të bëjnë me ekologjinë e mjediseve të ndotura në aspektin teorik dhe praktik në Kosovë dhe botë. Secili student do të zgjedhë temën specifike, për të cilën ai do të mbledhë informacion nga artikujt shkencorë, raste studimore ode dhe praktika të ndryshme. Studentët, rezultatet e mbledhura të do ti analizojnë dhe bazuar në rezultatet e fituara do të shkruajnë një raport të detajuar. Në fund secili student do të prezantojë punën e tij para studentëve të tjerë.
Politikat akademike dhe rregullat:
Pjesëmarrja e rregullt e studentëve në mësim është e dëshirueshme, por në ushtrime është e detyrueshme. Pajtueshmëria me orarin e leksioneve dhe ushtrimeve është e detyrueshme. Gjatë leksioneve dhe ushtrimeve përdorimi i telefonave celularë nuk lejohet.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore re
Titulli i lëndës:	Ekologji e peizazhit
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obliguese
Viti i studimeve:	Vitit i tret/semestri dimëror
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Departamenti i Biologjisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Avni Hajdari
Detajat kontaktuese:	avni.hajdari@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Përmes këtij kursi studentet do të njihen me konceptet themelore të ekologjisë së peizazheve, strukturën, proceset dhe dinamikën e ndryshimeve në peizazhe, ndikimet antropogjene në peizazhe, fragmentimi i habitateve, peizazheve kulturores si dhe mundësive të aplikimit parimeve të ekologjisë së peizazhit. Vëmendje e veçanet do ti kushtohet gjendjes së peizazheve në Kosovë, dhe mundësive të restaurimit të tyre. Gjatë shtjellimi të kursit do të inkorporohen shembuj nga praktikat e suksesshme të modelimit, menaxhimit dhe restaurimit të peizazheve të ndryshme.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i këtij kursi, është që përmes ligjëratave, punës praktike, modelimeve individuale/grupore të ju mundësoj studenteve zgjerimin e njohurive rreth koncepteve dhe parimeve kyçe në ekologjinë e peizazhit, si dhe aplikimin e tyre në biologjinë e konservimit.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kursit studentet duhet të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none"> - Përshkruajnë, dhe interpretojnë konceptet themelore të ekologjisë së peizazheve, - Aplikojnë konceptet të themelore të ekologjisë së peizazheve si mjete për konservim dhe menaxhim të natyrës, - Analizojnë ndryshimet e peizazheve të shkaktuara nga aktiviteti antropogjen - Përdorin softuerë të thjeshta dhe metodologji për modelimin dhe analizimin e peizazheve - Komunikojnë dhe prezantojnë në mënyrë kritike elementet dhe proceset që ndodhin në peizazh.
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënies të studentit)	

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja përfundimtare për provim	5	5	25
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	1	3	3
Projektet,prezantimet ,etj	1	2	2
			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Gjatë realizimit të kursit do të kombinohen metodologji të ndryshme të mësimdhënës si: ligjërata, mësim interaktiv, punë në grupe, debate, konsultime, pune praktike, etj.		
Metodat e vlerësimit:	Do të bëhet vlerësim i vazhdueshëm i te gjitha aktiviteteve të studentit, vlerësimi behët në pjesën praktike dhe teorike, përmes vlershmeve intermediere dhe provimit përfundimtar. Vlerësimi intermedier 30% Vijimi i rregullt 10% Prazantimi i modeleve 20% Provimi final 40% Total 100% Nota do të llogarite si më poshtë: 51%- 60% = 6 61% -70% = 7 71% - 80% = 8 81% - 90% = 9 91%-100% =10		
Literatura			
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> - Gergel, S.E. and M.G. Turner. 2002. Learning Landscape Ecology: A Practical Guide to ConceptandTechniques. NewYork, Springer-Verlag. - Turner, M. G., Gardner, R. H., O'Neill, R. V. 2001. Landscape Ecology in Theoryand Practice: Patternand Process. NewYork, Springer-Verlag - QGIS manual. Electronic version. https://docs.qgis.org/2.8/en/docs/training_manual/ 		
Literatura shtesë:			
Plani i dizajnuar i mësimit:			

Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	Hyrje në ekologjinë e peizazheve
Java e dytë:	Konceptet themelore, definimet dhe terminologjia në ekologjinë e peizazheve
Java e tretë:	Konceptet e shkallës së peizazhit, hyrje në modelimin e peizazheve
Java e katërt:	Struktura dhe funksionimi i peizazheve
Java e pestë:	Proceset dinamike në peizazhe
Java e gjashtë:	Regjimi i stresit në peizazh, faktorët abiotik dhe biotik
Java e shtatë:	Regjimi i stresit në peizazh, faktorët antropogjen (fragmentimi i peizazheve, lidhja e tyre, etj.) Vlerësim intermedier
Java e tetë:	Ekotoni dhe efektet e rrite së tij.
Java e nëntë:	Modelimet e peizazheve
Java e dhjetë:	Peizazhet kulturore
Java e njëmbëdhjetë:	Parimet e menaxhimit të peizazheve dhe konservimi i natyrës
Java e dymbëdhjetë:	Restaurimi peizazheve
Java e trembëdhjetë:	Gjenetika e peizazheve e (ekologjia e peizazheve dhe gjenetika e populacioneve)
Java e katërmëdhjetë:	Aplikimi i ekologjisë së peizazheve
Java e pesëmbëdhjetë:	Ekologjia globale Vlerësim intermedier
Java	Ushtrimet/puna praktike
Java e parë:	Metodat e studimit në ekologjinë e peizazheve
Java e dytë:	Aplikimi i të dhënave hapësinore në konservimin e natyrës
Java e tretë:	Aplikimi i të dhënave hapësinore – Google Earth Pro
Java e katërt:	Aplikimi i të dhënave hapësinore - Hyrje në Q-GIS
Java e pestë:	Matjet në ekologjinë e peizazheve –matje a parametrave jo-hapësinore
Java e gjashtë:	Mënyrat e matjes së parametrave hapësinor
Java e shtatë:	Analizimi i të dhënave hapësinore
Java e tetë:	Përzgjedhja e temave për punimin e modeleve të peizazhit
Java e nëntë:	Punë individuale/grupore në projekte modelimi
Java e dhjetë:	Punë individuale/grupore në projekte modelimi
Java e njëmbëdhjetë:	Punë individuale/grupore në projekte modelimi
Java e dymbëdhjetë:	Punë individuale/grupore në projekte modelimi
Java e trembëdhjetë:	Punë individuale/grupore në projekte modelimi
Java e katërmëdhjetë:	Prezantimi i projekteve të studentëve
Java e pesëmbëdhjetë:	Prezantimi i projekteve të studentëve

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar të vijojnë me rregull ligjërata dhe ushtrime. Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit dhe mbajtja e qetësisë në mësim po ashtu janë obligative.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore, Departamenti i Biologjisë, Drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit
Titulli i lëndës:	Ekologji e sjelljes së kafshëve
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	Viti III, semestri V
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	E enjte, 11.30-13.00, Laboratori i Zoologjisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.sc. Halil Ibrahim
Detajet kontaktuese:	044240225, halil.ibrahimi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë ka të bëjë me ligjshmëritë dhe konceptet e sjelljes tek kafshët, mënyrat e të mësuarit tek kafshët, ndikimin e sjelljes në të ushqyer, riprodhim, përkujdesje për të vegjlit, përkatësinë grupore si dhe aspektet fiziologjike dhe psikologjike të sjelljes.
Qëllimet e lëndës:	Programi mësimor i lëndës Ekologji e sjelljes së kafshëve ka për qëllim zhvillimin e njohurive rreth ekologjisë së sjelljes së kafshëve, komunikimit dhe ndërtimit të strukturave sociale si dhe aspektet praktike të këtyre çështjeve në mbrojtjen dhe konservimin e diversitetit të kafshëve.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none">• Njohin mënyrat e komunikimit midis kafshëve• Kuptojnë ndikimin e sjelljes në organizimin e jetës sociale• Analizojnë psikologjinë e altruizmit dhe konfliktit tek shtazët• Njohin ndikimin e sjelljes së kafshëve në jetën e kafshëve• Ndërlidhin njohuritë e biologjisë filogjenetike dhe biologjisë së konservimit me sjelljen e kafshëve

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokfiume,seminare	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	13	13
Përgatitja përfundimtare për provim	4	6	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	2	4
Projektet,prezantimet ,etj	2	2	4
			150
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Ligjërata, diskutime, ushtrime, punë praktike në laborator dhe terren, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuiume, provime.		
Metodat e vlerësimit:			
	Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Total 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Mihallaq Qirjo (2005): Etologjia , SHBLU Tiranë		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Michael Breed, Janice Moore (2014) Animal behavior, Elsevier, Netherlands 2. Marco Festa Bianchet, Marco Apollonia (2013) Animal Behavior and Wildlife Conservation, Island Press 3. Breland K., M. Breland (1966): Animal Behavior. The Macmillan Company, New York. 4. McFarland D. (1981): The Oxford Companion to Animal Behaviour. Oxford University Press, Oxford. 		

Plani i dizajnuar i mësimit:

Ligjëratat	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Historiati i Etologjisë dhe të kuptuarit e sjelljes
<i>Java e dytë:</i>	Aspekti fiziologjik i sjelljes tek kafshët
<i>Java e tretë:</i>	Aspekti gjenetik i sjelljes
<i>Java e katërt:</i>	Të mësuarit tek kafshët
<i>Java e pestë:</i>	Komunikimi tek kafshët
<i>Java e gjashtë:</i>	Sjellja sociale dhe hierarkitë tek kafshët
<i>Java e shtatë:</i>	Territorialiteti. Vlerësimi i parë
<i>Java e tetë:</i>	Sjellja riprodhuese
<i>Java e nëntë:</i>	Përkujdesja prindërore
<i>Java e dhjetë:</i>	Mekanizmat e vendimarrjes
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Strategjitë alternative
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Vetjakësia dhe altruizmi
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Jeta në grupe
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Etologjia dhe evolucioni
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Etologjia dhe evolucioni. Vlerësimi i dytë

Ushtrimet - Punë seminarike

Në kuadër të ushtrimeve studentët do të kryejnë punën seminarike ku do të përfshihen tema të ndryshme që kanë të bëjnë me ekologjinë e sjelljes së kafshëve në aspektin teorik dhe praktik në Kosovë dhe botë. Secili student do të zgjedhë temën specifike, për të cilën ai do të mbledhë informacion nga artikujt shkencorë, raste studimore ode dhe praktika të ndryshme. Studentët, rezultatet e mbledhura të do ti analizojnë dhe bazuar në rezultatet e fituara do të shkruajnë një raport të detajuar. Në fund secili student do të prezantojë punën e tij para studentëve të tjerë.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Shkycja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit si dhe mbajtja e qetësisë në mësim janë po ashtu të obligueshme.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN
Titulli i lëndës:	Ekologjia e pyjeve dhe mjedisi
Niveli:	3 vjeçar (Bachelor)/Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	FSHMN-Departamenti i Biologjisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Elez Krasniqi
Detajet kontaktuese:	+383 49 209 100 +383 44 209 100 elez.krasniqi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	Kursi Ekologjia e pyjeve dhe mjedisi përfshin njohuri të përgjithshme për ekosistemet pyjore dhe rëndësinë e tyre. Mësohet për ekosistemet pyjore në përgjithësi me theks të veçantë në pyjet kryesore të botës dhe ekologjinë e tyre. Mësohet gjithashtu për pyjet mezofile dhe termofile dhe ekologjinë e tyre. Në veçanti, studentëve ju shpjegohet gjendja reale e pyjeve të Kosovës, degradimi në pyjet e Kosovës dhe mënyrat e mundshme për mbrojtjen e tyre.
Qëllimet e lëndës:	Kursi i ofruar do ju mundësoj studentëve që fitojnë njohuri: <ol style="list-style-type: none">1. për ekosistemet e pyjeve në përgjithësi2. për karakteristikat kryesore të pyjeve kryesore në planetën tonë dhe ekologjinë e veçantë të tyre3. për pyjet termofile dhe mezofile në veçanti4. për gjendjen reale dhe degradimin e pyjeve të Kosovës5. për rëndësinë e pyjeve për mjedisin, dhe mundësitë e mbrojtjes së tyre
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kësaj lënde (kursit) studentët: <ol style="list-style-type: none">1. Do të kenë njohuri më të gjera për pyjet e Kosovës në përgjithësi2. Do ti kuptojnë formacionet kryesore të pyjeve në botë dhe do ti krahasojnë me ato të viseve tona3. Do ti njohin pyjet tona në aspektin floristik dhe organizativ4. Do të kuptojnë rëndësinë e pyjeve për mjedisin

	5. Do të jenë në gjendje që në bazë të njohurive të përfituara të përpilojnë plane aktive veprimi në mbrojtje të habitateve pyjore të Kosovës		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	1/15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	1/1	2
Punë praktike	1	1/7	7
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	1/7	7
Ushtrime në terren	2	1/14	28
Kollokfiume, seminare	2	2/15	30
Detyra të shtëpisë	2	1/5	10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	1/10	20
Përgaditja përfundimtare për provim	2	1/5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1/3	6
Projektet,prezentimet, etj	0	0	0
Totali			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime, punë praktike në terren, konsultime, Seminare, detyra shtëpie, vlerësime, provime.		
Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi në praktikë dhe në teori</p> <p>Vlerësimi:</p> <p>Vlerësimi i parë deri 30 %</p> <p>Vlerësimi i dytë deri 30 %</p> <p>Vijimi dhe detyrat deri 10 %</p> <p>Provimi final deri 30 %</p> <p>Totali 100 %</p>		
Literatura			
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> • Krasniqi, E. (2021): Ekologjia e pyjeve (Tekst për përdorim të brendshëm me ligjërata-Dispensë). UP-FSHMN. Prishtinë. • Rexhepi, F., Krasniqi, E. (2008): Ekologjia e pyjeve (Dispensë). Prishtinë. 		

	<ul style="list-style-type: none"> • Newton, A. (2007): Forest Ecology and Conservation: A Handbook of Techniques. Oxford University Press, UK. • Rexhepi, F. (2007): The vegetation of Kosovo 1, UP-FNS, Prishtinë.
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • Horvat, I., Glavac, V., Ellenberg, H. (1974): Vegetation Südosteuropas. Published by Gustav Fischer, Stuttgart, Germany. • Rexhepi, F. (1994): Vegjetacioni i Kosovës 1, UP, Prishtinë.

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në ekologjinë e pyjeve, biodiversiteti në ekosistemet pyjore, rëndësia e pyjeve
<i>Java e dytë:</i>	Disa karakteristika të ekosistemeve pyjore (Përkufizimi, burimet e energjisë dhe qarkullimi i materies në ekosistemet pyjore, biomasa, mikoriza)
<i>Java e tretë:</i>	Faktorët ekologjik në ekosistemet pyjore
<i>Java e katërt:</i>	Ekologjia e pyjeve tropikale dhe pyjeve monsune
<i>Java e pestë:</i>	Ekologjia e pyjeve të dafinës dhe pyjeve mediterane
<i>Java e gjashtë:</i>	Ekologjia e pyjeve dhe shkurreve verës të blerta gjetherënëse
<i>Java e shtatë:</i>	Vlerësimi i parë
<i>Java e tetë:</i>	Ekologjia e pyjeve të Kosovës, vështrim i përgjithshëm
<i>Java e nëntë:</i>	Ekologjia e pyjeve gjetherënëse të Kosovës (pyjet e shkozës dhe pyjet e qarrazit)
<i>Java e dhjetë:</i>	Ekologjia e pyjeve gjetherënëse të Kosovës (pyjet e bungëbutit dhe pyjet e shpardhit)
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Ekologjia e pyjeve gjetherënëse të Kosovës (pyjet e dushkut malor)
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Ekologjia e pyjeve gjetherënëse të Kosovës (pyjet e ahut)
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Ekologjia e pyjeve halore të Kosovës
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Menaxhimi i qëndrueshëm, degradimi dhe revitalizimi i ekosistemeve pyjore
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i dytë
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ushtrimet* që do të zhvillohen
<i>Java e parë:</i>	Ekologjia e pyjeve dhe rëndësia e saj (vizitë në pyllin më të afërm)
<i>Java e dytë:</i>	Faktorët ekologjik në pyll (vizitë në pyllin më të afërm)
<i>Java e tretë:</i>	Format jetësore në pyll (vizitë në pyllin më të afërm)
<i>Java e katërt:</i>	Bimët efemere në pyll (vizitë në pyllin më të afërm)
<i>Java e pestë:</i>	Pyjet gjetherënëse dhe halore të Kosovës (vizitë në pyllin më të afërm)

* Duke qenë se ushtrimet duhet të zhvillohen në pyll, ato mund të realizohen sipas mundësive reale teknike (një ose disa ushtrime brenda ditës)

Java e gjashtë:	Pyjet gjetherënëse të Kosovës-pyjet e shkozës dhe pyjet e qarraziut (vizitë në pyllin më të afërm)
Java e shtatë:	Vlerësimi i parë
Java e tetë:	Pyjet gjetherënëse të Kosovës – pyjet e bungëbutit dhe pyjet e shpardhit (vizitë në pyllin më të afërm)
Java e nëntë:	Pyjet gjetherënëse të Kosovës –pyjet e dushkut malor (vizitë në pyllin më të afërm)
Java e dhjetë:	Pyjet gjetherënëse të Kosovës –pyjet e ahut (vizitë në pyllin më të afërm)
Java e njëmbëdhjetë:	Pyjet halore të Kosovës (vizitë në pyllin më të afërm)
Java e dymbëdhjetë:	Formacionet pyjore përgjatë rrjedhave ujore në Kosovë-“pyjet e kaltra” (vizitë në pyllin më të afërm)
Java e trembëdhjetë:	Veprimi negative antropogjen në pyll (vizitë në pyllin më të afërm)
Java e katërbëdhjetë:	Veprimi pozitiv antropogjen në pyll (vizitë në pyllin më të afërm)
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë

** Duke qenë se ushtrimet duhet të zhvillohen në pyll, ato mund të realizohen sipas mundësive reale teknike (një ose disa ushtrime brenda ditës)*

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët duhet të jenë të rregullt në mësim, aktiv gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve, të përgatiten, të jenë në gjendje të marrin te dhëna nga interneti, të bëjnë pyetje gjatë seancave mësimore. Duhet të mbajnë disiplinë, t'i shkyçin telefonat celular, të vijnë me kohë në ligjërata dhe në ushtrime dhe mos të pengojnë mbarëvajtjen e mësimi.

Ekologjia humane dhe mjedisi

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
Titulli i lëndës:	Ekologjia humane dhe mjedisi
Niveli:	Bachelor/Bsc
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II/semestri III
Numri i orëve në javë:	2+2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.assoc.Dr.Ferdije Zhushi Etemi
Detajet kontaktuese:	e-mail: ferdijezhushi2010@gmail.com; ferdije.zhushi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	Kjo lëndë studion mardheniet dhe ndërveprimet e njeriut me mjedisin e tij jetësor. Këto ndërveprime përfshijnë ndikimin e njeriu në ekosistemin e ajrit, ujit, tokës dhe në biodiversitet, si rezultat i shfrytëzimit të tyre për nevoja të tij. Në kuadër të kësaj lënde studiohet edhe popullata njerëzore, rritja e saj gjatë historisë, urbanizimi dhe trendet e zhvillimit të saj si dhe burimet e energjisë dhe eksploatimi i tyre.
Qëllimet e lëndës:	<ul style="list-style-type: none"> • Të kuptohet roli i njeriut në natyrë dhe bashkëveprimi i tij me mjedisin jetësorë. • Të zhvillohet të menduarit kritik mbi shfrytëzimin e resurseve natyrore nga njeriu • Të njoftohen studentët me zhvillimin e popullatës njerëzore, rritjen e saj dhe problemet e qyteteve të mëdha si pasojë e mbipopullimit të tyre . • Të njoftohen studentët me shkaktarët dhe pasojat e ndotjes së ekosistemeve të tokës, ajrit dhe ujit • Të zhvillohen aftësitë dhe shkathtësitë e identifikimit të problemeve të mjedisit të lidhura me veprimin antropogjen në ekosistem dhe propozimi i masave për parandalim.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti do të jetë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kupton procesin e ndërveprimit të njeriut me mjedisin jetësor dhe qenjet tjera • Njeh historikun e zhvillimit të popullatës

	<p>njerzore dhe problemet me të cilat ajo ballafaqohet</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikon shkaktarët e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës si dhe pasojat e veprimtarisë së njeriut • Analizon pasojat e ndotjes antropogjene për mjedisin jetësor dhe njeriun • Propozon masa për parandalimin e degradimit të mjedisit jetësorë
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.5	6	3
Kollokfiume,seminare	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	3	10	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	5	5
Totali			150

Metodologjia e mësimdhënies: Ligjërata (PP), diskutim, ushtrime në teren,punë në grupe, prezantime të studentëve

Metodat e vlerësimit: Prezantimi I posterëve (projektet) 50%
Vlerësimi final 50%

Literatura

Literatura bazë: Gerald G.Marten:Human Ecology, Earthscan Publication,2001,ribotim 2004
Pollozhani A., Selvete Krasniqi: Ekologjia humane, 2009

Literatura shtesë: 1. Enger and Smith: Environmental Science –a study of interrelationships McGrawHill 2002

Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në Ekologji humane, kuptimi fizik, biologjik dhe social i mjedisit jetësor
<i>Java e dytë:</i>	Ndërveprimet e njeriut me mjedisin- Cikli i azotit, i karbonit, fosforit dhe sulfurit-ndikimi i njeriut në qarkullimin e nutrientëve
<i>Java e tretë:</i>	Karakteristikate populatës njerëzore-nataliteti dhe mortaliteti, gjinia dhe mosha
<i>Java e katërt:</i>	Trendet dhe implikimet e popullatës njerëzore-historiku i zhvillimit, rritja, standardi jetësor, uria, prodhimi i ushqimit dhe degradimi i mjedisit
<i>Java e pestë:</i>	Perspektiva globale-Urbanizimi
<i>Java e gjashtë:</i>	Energjia dhe civilizimi-burimet e energjisë
<i>Java e shtatë:</i>	Ndotja e mjedisit dhe historiku i saj
<i>Java e tetë:</i>	Ndikimi i njeriut në resurse dhe Ekosisteme Ndikim i njeriut në ekosisteme tokësore
<i>Java e nëntë:</i>	Ndikimi i njeriut në ekosisteme ujore
<i>Java e dhjetë:</i>	Ndotja e ajrit dhe pasojat
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Ndikimi i njeriut në Biodiversitet
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Prezentimet e postereve të grupeve punuese/projekteve të studentëve
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Ndikimi i ndotjes së mjedisit në shëndetin e njeriut
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Ngrohja Globale dhe ndryshimet klimatike-pasojat
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Permbledhje e lendes: Shiqimi dhe diskutimi i filmit dokumentar HOME

Pjesa praktike/në teren

Ushtrimi 1	Popullata njerëzore-llogaritja e natalitetit dhe mortalitetit
Ushtrimi 2	Mbledhje e fakteve në teren për ndotjen e ekosistemeve të ujit
Ushtrimi 3	Analizat kimike dhe bakteriologjike të ujit-Instituti Kombëtar I Shëndetit public
Ushtrimi 4	Matja e parametrave të ajrit-vizitë në institutin Hidrometeorologjik
Ushtrimi 5	Mbledhje e fakteve në teren për ndotjen e ekosistemeve të tokës-vizitë në Termocentralet në afërsi të Prishtinës
Ushtrimi 6	Ndikimi i trafikut dhe transportit në ndotjen e mjedisit
Ushtrimi 7.	Zonat e mbrojtura të natyrës-vizitë në një zonë
Ushtrimi 8	Vizite në Zonën e gjuetisë me vlera të posaqme në Blinajë-rolin I zonave të mbrojtura në ruajtjen e biodiversitetit

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Gjatë vijimit në këtë lëndë nga studentët kërkohet: vijim i rregullt i ligjëratave dhe ushtrimeve, dhënja e kontributit në diskutimet për temat e ligjëruara, mbajtja e qetësisë në mësim, shkyqja e telefonave celular dhe hyrja në sallë me kohë.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
Titulli i lëndës:	Fitoekologji me fitogjeografi
Niveli:	BSc.
Statusi lëndës:	Obliguese
Viti i studimeve:	Viti i dytë/semestri verorë
Numri i orëve në javë:	2+2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Departamenti i Biologjisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Behxhet Mustafa
Detajet kontaktuese:	behxhet.mustafa@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	<p>Studentët do të njihen me parimet themelore ekologjike, faktorët ekologjik dhe ndërveprimet e bimëve dhe bashkësive bimore me mjedisin e jashtëm (faktorët abiotik dhe biotik). Kursi është i përberë prej tri pjesëve: në pjesën e parë autekologjia, do të trajtohen faktorët ekologjikë dhe rolin e tyre në krijimin e formave jetësore dhe përhapjen e bimëve, si dhe ndikimi i faktorit njeri në bimë. Në pjesën e dytë (sinekologjia apo fitocenologjia) do të shtjellohen bashkësitë bimore, struktura e tyre floristike, marrëdhëniet e bimëve brenda bashkësisë bimore, si dhe proceset dinamike që ndodhin në bashkësitë bimore në raport me mjedisin e jashtëm, ndërsanë pjesën e tretë (fitogjeografia) do të diskutohen përhapja e bashkësive bimore në regjione të ndryshme gjeografike.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Kursi ka për qëllim që përmes ligjëratave, prezantimeve grupore, punës laboratorike dhe asaj në terren të ju mundësoj studenteve zgjerimin e njohurive rreth koncepteve dhe parimeve kyçe në ekologjinë e bimëve.</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit të kursit studentët do të jenë në gjendje që të:</p> <ul style="list-style-type: none">- Interpretojnë parimet themelore ekologjike.- Analizojnë ndërveprimin e faktorëve ekologjik në strukturën, funksionimin dhe përhapjen e bimëve si dhe ndikimin që faktorët ekologjik kanë strukturën dhe dinamiken e bashkësive bimore.- Vlerësojnë ndikimin e aktivitetet njerëzore në funksionin dhe përhapjen e bimëve dhe bashkësive bimore.- Interpretojnë ligjshmëritë e shoqërimit të grupeve të veçanta të bimëve si dhe ligjshmëritë e përhapjes së bashkësive bimore në rruzullin tokësor.- Kuptojnë teknikat gjithëpërfshirës për analizimin dhe

	<p>vizualizimin e të dhënave për popullacionet e bimëve dhe bashkësive të bimëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Aplikojnë teknikat e zakonshme në terren që përdoren në ekologjinë e bimëve. - Në mënyrë efektive prezantojnë të dhënat e gjetura përmes shkrimit të raporteve bazuar nga gjetje në terren.
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.5	6	3
Kollokfiume,seminare	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	3	10	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	5	5
Totali			150

Metodologjia e mësimdhënies:	Gjatë realizimit të kursit do të kombinohen metodologji të ndryshme të mësimdhënës si: ligjërata, mësim interaktiv me studentin në qendër, punë në grupe,debate, konsultime, punë praktike në terren dhe laborator, etj.
Metodat e vlerësimit:	<p>Do te behet vlerësim i vazhdueshëm i të gjitha aktiviteteve të studentit, puna ne terren, puna ne laborator, shkathtësitë manovruese me aparate dhe instrumente laboratorike etj. Vlerësimi bëhet në pjesën praktike dhe teorike, përmes vlerësimeve intermediere dhe provimit përfundimtar.</p> <p style="padding-left: 40px;">Vlerësimi intermedier 30%</p> <p style="padding-left: 40px;">Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10%</p> <p style="padding-left: 40px;">Vijimi i rregullt 10%</p> <p style="padding-left: 40px;">Provimi final 50%</p> <p style="padding-left: 40px;">Total 100%</p> <p>Nota do të llogarite si më poshtë:</p>

	<p>51%- 60% = 6 61% -70% = 7 71% - 80% = 8 81% - 90% = 9 91%-100% =10</p>
Literatura	
Literatura bazë:	<p>Hoxha,E. Mustafa. B (2004):<i>Ekologjia e bimëve.Universiteti i Prishtinës.Prishtinë.</i> Hoxha,E,Mustafa,B (1996):<i>Ekologjia e bimëve (praktikum).Universiteti i Prishtinës.Prishtinë</i> Hoxha,E,Mustafa,B (2000): <i>Fitocenologjia me fitogjeografi. Universiteti i Prishtinës.</i></p>
Literatura shtesë:	<p>Ernst-Detlef Schulze, Erwin Beck, Nina Buchmann, Stephan Clemens, Klaus Müller-Hohenstein, Michael Scherer-Lorenzen (2019). <i>Plant Ecology. 2nt edition, Plant Ecology</i></p>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje, parimet edhe konceptet themelore të ekologjisë
<i>Java e dytë:</i>	Ekosistemi dhe produktiviteti i tij
<i>Java e tretë:</i>	Autekologjia: faktorët ekologjik, ekologjia e stresit
<i>Java e katërt:</i>	Drita si faktor ekologjik
<i>Java e pestë:</i>	Temperatura si faktor ekologjik
<i>Java e gjashtë:</i>	Uji si faktor ekologjik
<i>Java e shtatë:</i>	Toka dhe ajri si faktor ekologjik Vlerësim intermedier
<i>Java e tetë:</i>	Grupet ekologjike të bimëve
<i>Java e nëntë:</i>	Faktorët biotik
<i>Java e dhjetë:</i>	Sinekologjia: historiku i vegjetacionit, tipet e klasifikimit, metodat e studimit të vegjetacionit
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Dinamika e vegjetacionit, suksesioni, përhapja e bashkësive bimore
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Tipet e vegjetacionit
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Fitogjeografia
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Regjionet floristike
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Përmbledhje e vegjetacionit të Kosovës Vlerësim intermedier
Java	Ushtrimet që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Metodat e hulumtimit në fitoekologji
<i>Java e dytë:</i>	Teknikat për mbledhjen e të dhënave në ekologjinë e bimëve
<i>Java e tretë:</i>	Teknikat për analizimin dhe interpretimin e të dhënave

Java e katërt:	Drita - metodat për matjen e saj
Java e pestë:	Temperatura - metodat matjes së saj
Java e gjashtë:	Lagështia - metodat e matjes së saj
Java e shtatë:	Konstruktimi i klimadiagramit
Java e tetë:	Marrja e mostrave të dheut, intensiteti i evaporimit, pH-ja e tokës dhe sasia e CaCO ₃ në tokë
Java e nëntë:	Matja e intensitetit të transpirimit
Java e dhjetë:	Matja e shtypjes osmotike dhe përqendrimit të lëngut qelizor
Java e njëmbëdhjetë:	Matja e sasisë së klorofilit në gjethe
Java e dymbëdhjetë:	Përgatitja e preparateve dhe matjet mikroskopike
Java e trembëdhjetë:	Analizimi i veçorive anatomike nga forma të ndryshme jetësore
Java e katërmëdhjetë:	Rilevimet fitocenologjike në bashkësi barishtore
Java e pesëmbëdhjetë:	Rilevimet fitocenologjike në bashkësi drunore

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata, marrin pjesë në vizita studimore në terren (punë në terren). Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimin dhe mbajtja e qetësisë në mësim poashtu janë obligative.

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore Departamenti i biologjisë
Titulli i lëndës:	Fizika
Niveli:	Ekologji dhe Mbrojtje e Ambientit - bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve/ Semestri	Viti i parë, Semestri i dytë
Numri i orëve në javë:	2 + 2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	E enjte 16 ⁰⁰ – 17 ³⁰ , Amfiteatri i fizikës
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Dr. Sadik Bekteshi
Detajet kontaktuese:	sadik.bekteshi@uni-pr.edu Koha e konsultimeve: E hënë, e martë, e mërkurë, 13 ⁰⁰ – 14 ³⁰ Projektet dorëzohen në fund të semestrit
Përshkrimi i lëndës	Ky është një kurs bazë një-semestral i fizikës për studentët e ekologjisë (biologjisë). Ekologjia është studimi i kompleksitetit të botës në të cilën jetojmë dhe qëndrueshmërinë e tij, duke analizuar proceset natyrore të botës dhe sistemet të cilat bazohen edhe në ligjet e fizikës. Ky kurs prezanton konceptet themelore dhe ligjet e fizikës me qëllim të zbatimit në shumë fusha të ekologjisë si në studimin e fenomeneve që përcaktojnë shkallën e transferit të energjisë dhe masës dhe përdorimin e ligjeve të ruajtjes për të analizuar buxhetet e masës dhe energjisë së organizmave të gjallë etj. Ushtrimet laboratorike janë obligative.
Qëllimet e lëndës:	Ky kurs synon të ndihmojë studentët: - të zhvillojnë njohjen konceptuale të ligjeve dhe koncepteve të fizikës - të fitojnë shkathtësi për modelimin e shkëmbimit të energjisë dhe masës midis organizmave të gjallë dhe mjedisit të tyre. - të zhvillojnë shkathësitë e punës laboratorike, të komunikimit dhe punës në grup
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të: - kuptoj dhe shpjegoj konceptet që janë të rëndësishme për kinematikën, përfshirë zhvendosjen, shpejtësinë dhe nxitimin - dalloj dhe shpjegoj ligjet e lëvizjes së Njutonit.

	<ul style="list-style-type: none"> - kuptoj dhe shpjegoj konceptet që janë të rëndësishme për mekanikën, përfshirë punën, energjinë, impulsin dhe momentin, si dhe elasticitetin e materialeve. - përshkruaj dhe shpjegoj forcat dhe shtypjet që lëngjet ushtrojnë kur janë në qetësi dhe kur janë në lëvizje. - përshkruaj dhe shpjegoj konceptet që janë të rëndësishme për temperaturën dhe nxehtësinë. - përshkruaj dhe shpjegoj natyrën e valëve. - kuptoj dhe shpjegoj forcat elektrike, fushat elektrike, energjinë potenciale elektrike, forcat magnetike, fushat magnetike dhe valët elektromagnetike. - kuptoj ligjet themelore të optikës. - dalloj dhe shpjegoj grimcat elementare, radioaktivitetin dhe rrezatimin jonizues. - hulumtoj në mënyrë eksperimentale fenomenet e caktuara fizike 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Vlerësimet intermediare	1	15	15
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanë të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	4	2	8
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	3	3
Projektet,prezentimet ,etj	2	2	4
Totali			150 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	Metodologjia e mësimdhënies bazohet në: ligjërata, ushtrime laboratorike, konsultime, punë në shtëpi, vlerësime intermediare, diskutime, projekte, provime, punë në grup.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë:		20%

	Vlerësimi i dytë:	20%
	Projektet dhe detyrat e shtëpisë:	10%
	Vijimi i rregullt:	5%
	Provimi përfundimtar:	45%
	Totali:	100%
Literatura		
Literatura bazë:	D. Halliday, R. Resnik, J. Walker, Fundamental of Physics- Sixth Edition, John Willey & Sons Inc, Dr. Qerim Kamberi, Fizika e përgjithshme, Prishtinë, 1998	
Literatura shtesë:	Gaylon S. Campbell John M. Norman An Introduction to Environmental Biophysics Sec Edit Springer-Verlag New York, Inc.1998 Dr. S. Skenderi, Dr. R. Maliqi, Fizika për studentët e fakulteteve teknike, Prishtinë.	

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Kinematika.
<i>Java e dytë:</i>	Forcat dhe ligjet e lëvizjes të Njutonit.
<i>Java e tretë:</i>	Puna dhe energjia.
<i>Java e katërt:</i>	Impuls dhe sasia e lëvizjes.
<i>Java e pestë:</i>	Elasticiteti dhe lëkundjet.
<i>Java e gjashtë:</i>	Fluidet.
<i>Java e shtatë:</i>	Temperatura dhe nxehtësia.
<i>Java e tetë:</i>	Termodinamika Vlerësimi i parë.
<i>Java e nëntë:</i>	Valët dhe zeri.
<i>Java e dhjetë:</i>	Forcat dhe fushat elektrike.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Forcat dhe fushat magnetike.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Valët elektromagnetike.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Optika.
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Grimcat dhe valët.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Fizika bërthamore dhe radioaktiviteti, rrezatimi jonizues. Vlerësimi i dytë.

Plani i detajuar i ushtrimeve eksperimentale

<i>Java e parë:</i>	Matja e gjatësisë me nonius dhe vidë mikrometrike
<i>Java e dytë:</i>	Përcaktimi i nxehtësisë së avullimit të ujit me kalorimetër
<i>Java e tretë:</i>	Përcaktimi i peshës specifike të lëngjeve me hidrometër
<i>Java e katërt:</i>	Përcaktimi i nxehtësisë specifike të trupave të ngurtë me kalorimetër
<i>Java e pestë:</i>	Përcaktimi i indeksit të thyerjes me mikroskop optik
<i>Java e gjashtë:</i>	Përcaktimi i koeficientit të viskozitetit të lëngjeve me metodën e Stoksit
<i>Java e shtatë:</i>	Përcaktimi i raportit C_p/C_v të nxehtësisë specifike të ajrit
<i>Java e tetë:</i>	Vërtetimi i ligjit të Boyle-Mariott-it
<i>Java e nëntë:</i>	Vërtetimi i ligjit të Ohm-it
<i>Java e dhjetë:</i>	Përcaktimi i rezistencës së panjohur me urën e Wheatstone-it
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Përcaktimi i largësisë fokale të thjerrëzës me metodën direkte dhe të Besselit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Përcaktimi i fuqisë së nxemësit elektrik
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Përcaktimi i nxitimit të rëndimit tokësor me lavjerrës matematik
<i>Java e katërmbëdhjetë:</i>	Përcaktimi i modulit të elasticitetit me metodën e Young-ut
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Përcaktimi i peshës specifike të trupave të ngurtë me peshojë hidrostatike

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- Pritet që studenti të përcjell me rregull ligjëratat përderisa ushtrunet laboratorike janë të obligueshme
- Studentët duhet të mbajnë qetësi në sallë dhe të jenë të koncentruar në mësim
- Gjatë kohës së ligjëratave të shkyqen telefonat celular

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore Departamenti i Biologjisë Programi: Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit
Titulli i lëndës:	Fiziologjia e bimëve
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	II (i dytë)
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	E martë dhe mërkure, ora: 10-12, FSHMN
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Ass. Dr. Bekim Gashi
Detajet kontaktuese:	bekim.gashi@uni-pr.edu; cel: +386 49 600 850
Përshkrimi i lëndës	
	Hyrje në fiziologjinë e bimëve. Qeliza bimore - funksionet e: membranave qelizore, murit qelizor, mikrotrupthave, plastideve, vakuolës dhe citoskeletit. Uji dhe qeliza bimore – mekanizmat e absorbimit, transportit dhe lirimit. Ushqimi mineral i bimëve. Asimilimi i materieve minerale. Fotosinteza, reaksionet fotokimike, transporti i elektroneve, sinteza e ATP. Cikli i Kalvinit. Metabolizmi C3, C4 dhe CAM. Fotofrymëmarrja. Faktorët që ndikojnë në fotosintezë. Procesi i frymëmarrjes te bimët. Rritja dhe zhvillimi i bimëve, rregullatorët e rritjes. Fiziologjia e rezistencës së bimëve dhe metabolitët sekondar. Lëvizjet e bimëve.
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka si qëllim që studentëve t'u ofrojë njohjen e proceseve fiziologjike që kryhen në organizmat bimor dhe njohjen e ligjshmërive fiziko-kimike që mundësojnë kryerjen e proceseve të ndryshme fiziologjike.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Me përfundimin e këtij kursi, studentët do të jenë në gjendje që: <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojë se si aplikohen konceptet bazë të Fiziologjisë së bimëve në disiplinat e tjera të biologjisë. • Të analizojnë lidhshmëritë ndërmjet strukturës dhe funksionit të qelizës në nivele të ndryshme. • Të kuptojnë rëndësinë e procesit të ushqimit mineral, transpirimit, fotosintezës dhe të frymëmarrjes te organizmat bimor. • Të kuptojnë dhe të shpjegojnë proceset e rritjes

	<p>dhe zhvillimit të bimëve.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përdorin materialin bimor, pajisjet laboratorike dhe metodat e aplikuara në fiziologjinë e bimëve. • Të aplikojnë konceptet bazë të praktikës së fiziologjisë së bimëve në praktikë. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15 javë	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15 javë	30
Punë praktike	5	1 javë	5
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5 javë	5
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokfiume,seminare	2	2 javë	4
Detyra të shtëpisë	/	/	/
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	10 javë	10
Përgaditja përfundimtare për provim	3	10 javë	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	6	1 javë	6
Projektet,prezentimet ,etj	/	/	/
Totali			120
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime praktike në laborator, konsultime, projekte të pavarura, kuize, detyra shtëpie, kollokuiume, provime.		
Metodat e vlerësimit:	<p>1. Mundësia e vlerësimit gjatë leksioneve:</p> <p>Vlerësimi i parë (kolokvium, pyetje të mbyllura): 30%</p> <p>Vlerësimi i dytë (kolokvium, pyetje gjysmë të hapura): 30%</p> <p>Vlerësimi përfundimtarë (pyetje të hapura): 30%</p> <p>Seminaret ose angazhime tjera: 10%</p> <p>Total: 100%</p> <p>2. Apo pas përfundimit të leksioneve (në afatet e provimeve):</p> <p>Vlerësimi me test me njërën nga tri format e sipërpërmendura apo provim me gojë.</p>		
Literatura			

Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Lincoln Taiz, Eduardo Zeiger, Ian M. Moller and Angus Murphy: Fiziologjia dhe zhvillimi i bimëve, 6th edition (in Albanian). Oxford University Press, 2014. 2. Bekim Gashi: Praktikum i Fiziologjisë së bimëve (dispensë), 2015.
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> • Vjollca Ibro: Fziologjia e bimëve. Universiteti Bujqësor i Tiranës, 2002. • Lincoln Taiz and Eduardo Zeiger: Plant Physiology, 5th edition, Sunderland, USA, 2010. • Fiziologjia e bimëve (dispensë ligjëratash).

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në fiziologjinë e bimëve. Qeliza bimore – funksionet e membranave qelizore, plastideve, mikrotrupthave, vakuolës dhe citoskeletit.
<i>Java e dytë:</i>	Muri qelizor – funksionet dhe biosinteza. Përbërja kimike e protoplazmës.
<i>Java e tretë:</i>	Uji dhe qelizat bimore – absorbimi, transporti dhe lirimi i ujit.
<i>Java e katërt:</i>	Ushqimi mineral i bimëve. Elementet makrometabolike dhe mikrometabolike.
<i>Java e pestë:</i>	Asimilimi i materieve minerale (azoti, sulfuri, fosfori, oksigjeni, kationet).
<i>Java e gjashtë:</i>	Fotosinteza – organizimi i aparatit fotosintetik, reaksionet fotokimike.
<i>Java e shtatë:</i>	Cikli i Kalvinit dhe rregullimi i tij. Fotofrymëmarrja. Bimët e tipit C3, C4 dhe CAM. <i>Vlerësimi i parë intermedier.</i>
<i>Java e tetë:</i>	Aspektet fiziologjike dhe ekologjike të fotosintezës. Sinteza e amidonit dhe saharozës. Transporti i asimilateve nëpër floemë.
<i>Java e nëntë:</i>	Procesi i frymëmarrjes në bimë. Metabolizmi i sheqernave dhe yndyrnave. Heterotrofia te bimët.
<i>Java e dhjetë:</i>	Rritja, diferencimi dhe zhvillimi i bimëve.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Hormonet bimore: auksinet dhe giberelinet.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Hormonet bimore: citokininet, etilen, acidi abscisik dhe substancat tjera endogjene.

Java e trembëdhjetë:	Ndikimi i faktorëve të jashtëm në rritje dhe zhvillim të bimëve. Efekti i dritës në rritjen dhe zhvillimin e bimëve.
Java e katërbëdhjetë:	Fiziologjia e streseve bimore. Metabolizmi sekondar dhe mekanizmat e mbrotjes së bimëve
Java e pesëmbëdhjetë:	Fiziologjia e lëvizjes së bimëve. <i>Vlerësimi i dytë intermedier.</i>

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<i>Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.</i>

Ushtrimet

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ushtrimi që do të zhvillohet
Java e parë:	Njoftim i përgjithshëm me praktikat e Fiziologjisë bimore – sqarimi mbi hartimin e një Raporti laboratorik bashkërisht, Praktikumit dhe Planprogramit.
Java e dytë:	Lëshueshmëria e membranave qelizore bimore nën ndikimin e faktorëve kimik dhe fizik (ndikimi i tretësve organik, i acideve dhe bazave, i joneve dhe i temperaturave të larta).
Java e tretë:	Osmoza – Qelizat Traube dhe të Phefferit. Plazmoliza e qelizave bimore.
Java e katërt:	Fuqia thithëse e indeve bimore dhe metodat për përcaktimin e saj. Lëshueshmëria për ujë e kërcejve drunor.
Java e pestë:	Regjimi ujqor i bimëve – përcaktimi i sasisë së ujit të lirë, ujit higroskopik, ujit të tërësishëm në bimë dhe sasisë relative të ujit (RWC).
Java e gjashtë:	Transpirimi – demonstrimi i tij nga faqja dhe kundërfaqja e gjethit. Matja e intensitetit të transpirimit me metodën peshuese dhe me ndihmën e gypit “U”.
Java e shtatë:	Demonstrimi i gutimit në kushte laboratorike. Përcaktimi i sipërfaqes asimiluese (me metodën e konturave të gjethes në letër dhe me metodën e copave rrethore).

<i>Java e tetë:</i>	Analiza kualitativo-kuantitative e pigmenteve të kloroplastit me metodën UV-VIS spektrofotometrike
<i>Java e nëntë:</i>	Ndarja e pigmenteve të kloroplastit me metodën e kromatografisë në letër. Vërtetimi i veçorive të klorofileve (ndikimi i acideve dhe i bazave në klorofil, fluoreshenca e klorofilit).
<i>Java e dhjetë:</i>	Identifikimi i karbohidrateve të krijuara gjatë procesit të fotosintezës (identifikimi i amidonit në gjethe & identifikimi i sheqernave reduktuese).
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Fermentimi alkoolik.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Matja e aktivitetit të Amilazës.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Përcaktimi i aktivitetit të Saharazës.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Analiza kualitative e hirit (kalciumi, hekuri dhe sulfuri).
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Hulumtimi biokimik i vitalitetit të farave.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN, Departamenti i Biologjisë
Titulli i lëndës:	Fiziologjia e shtazëve
Niveli:	bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III , semestri i pestë
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Departamenti i Biologjisë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. dr. Kemajl Bislimi
Detajet kontaktuese:	kemajlbislimi@yahoo.com kemajl.bislimi@uni-pr.edu tel. 044-243-470
Përshkrimi i lëndës	Lënda fiziologjia shtazëve në këtë kurs jep informacione lidhur me proceset bazike të fiziologjisë, të tilla si homeostaza dhe mekanizmat tjere rregullues. Poashtu tregon tipet e sistemit të tretjes të grupet e ndryshme të organizmave. Një hapësirë i kushtohet lëngjeve trupore hemolimfa, gjaku, plazma dhe elementet e gjakut si dhe roli i tyre, duke përshkruar format e imunitetit. Gjithashtu trajtohet edhe sistemi i qarkullimit të gjakut dhe procesit të frymëshkëmbimit. Në kapitullin e sistemit nervor ipen informata për rolin si dhe për format tjera të komunikimit sinaptik dhe hormonal. Në kapitujt e fundit spjegohen organet ekskretuese si dhe metabolizmi energjetik duke përfshirë metodat e matjes direkte dhe indirekte.
Qëllimet e lëndës:	Programi mësimor i lëndës Fiziologjia e shtazëve, ka për qëllim që studenti të: -zhvilloj aftësi për të njohur dhe kuptuar proceset, funksionet dhe manifestimet fiziologjike dhe interpretuar saktë mekanizmat e homeostazës, - zgjeroj dhe thelloj njohuritë për morfologjinë funksionale të membranës qelizore dhe transportin transmembranor të materieve në të, anatominë fiziologjike të qelizës nervore dhe muskulore, -të njoh terminologjinë fiziologjike , të kuptoj faktet, konceptet ,parimet dhe metodat fiziologjike si dhe relacionin shkak –efekt, - të zhvillojë të menduarit kritik të funksionimit të sistemeve të tretjes, qarkullimit të gjakut, frymëshkëmbimit, nervor, imunitar, ekskretues -fitoj aftësi për mbledhje dhe përpunim të të dhënave relevante shkencore nga fiziologjia prej burimeve të ndryshme dhe shkathtësi, për të zbatuar njohuritë e fituara në praktikë.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Në përfundim të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje të: 1.Shpjegon faktet, konceptet, parimet dhe metodat fiziologjike dhe sjellë shembuj për relacionin shkak –efekt, fedbackun pozitiv dhe

	<p>negativ dhe përshkruan mekanizmat rregullues të homeostazës</p> <p>2.Emerton tipet e ndryshme të lëngjeve trupore, përshkruan përbërjen e gjakut dhe rolin fiziologjik të elementeve korpuskulare dhe plazmës së gjakut.</p> <p>Vlerëson rëndësinë e sistemit të organeve për qarkullimin e lëngjeve trupore.</p> <p>3.Shpjegon bazën qelizore dhe humorale të përgjigjes imunologjike,dallon imunitetin aktiv nga imuniteti pasiv si dhe imunitetin specifik nga imuniteti jo specifik</p> <p>4.Shpjegon konceptet e përgjithshme fiziologjike për frymëshkëmbimin, tretjen, ekskretimin, sistemin lokomotor, sistemin rregullues (endokrin dhe nervor) dhe metabolizmin energjetik.</p> <p>5.Dallon tipet e organeve të frymëmërrjës, të tretjes dhe organeve ekskretuese të grupet e ndryshme sistematike dhe dhe shpjegon mekanizmin e funksionimit të tyre.</p> <p>6. Përshkruan anatominë dhe fiziologjinë (dhe organizimin brendaqelizor) të qelizës nervore dhe muskulore, argumenton bazën jonike të potencialeve bioelektrike</p> <p>7.Analizon mekanizmin e përcjelljes së impulsit nga një qelizë në tjetrën-sinapsat</p> <p>8. Grumbullon të dhëna shkencore relevante nga interneti dhe burime tjera lidhur me temat e zhvilluara.</p>		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënësit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	-	-	-
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	-		-
Kollokfiime,seminare	1	2	2
Detyra të shtëpisë	-	-	
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	4	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj			
Totali			126
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Ligjerata tradicionale, mësim interaktiv me studentin në qendër, punë në grupe, diskutim, debate etj. Puna në grupe do të jetë një prej mënyrave të garimit për të nxënë sa më shumë njohuri dhe për të rritur një konkurrencë pozitive brenda studentëve. Për ilustrim të fakteve dhe koncepteve do të zgjedhë materiale vizuale: si sllajde, figura, skema, videprojektor, modele etj. Për zhvillimin e</p>		

	njohurive, aftësive dhe shkathtësive të plota dhe të qëndrueshme, do të përzgjedhen metoda më të përshtashme të mësimdhënies e mesimnxënies në mënyrë që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të studentit.
Metodat e vlerësimit:	Do të përdorë mjete dhe teknika të ndryshme për të mbledhur informacione të mjaftueshme për vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së studentit Vlerësimi bëhet në pjesën praktike dhe teorike. Pjesa praktike e provimit është eliminuese. Vlerësimi në pjesën teorike të lëndës do të bëhet duke aplikuar variantin e vlerësimit sipas procesit të Bolonjës dhe tradicional (me gojë) me zbatim të tri segmenteve të objektivit (veprimin, kushtin dhe kriterin). Përqindja e pikave në vlerësim Vlerësimi i parë 40 % Vlerësimi i dytë 40 % Angazhime të tjera 15 Vijimi i rregullt 5% Total 100% Pikët e fituara do të konvertohen në notë sipas sistemit ECTS.
Literatura	
Literatura bazë dhe e preferuar:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dervish A. Rozhaja, Fiziologjia krahasuese, Prishtinë, 2000 2. S.C. Rastogi, Essentials of animal physiology, New Age International Ltd., Publishers, 2007 3. Ethem Ruka, Fiziologjia e gjallesave shtazore, Tiranë, 1999 4. Fetah Halili, Fiziologji e përgjithshme, Prishtinë, 1997 5. Tefta Rexha, Biologjia qelizore dhe molekulare, Tiranë, 2002 6. Artan Shkoza, Fiziologjia e njeriut, Tiranë, 2009 7. Herve Guenard, Fiziologjia e njeriut, 1996 8. Luljeta Çakërri, Rexhep Bregu, Fiziologjia mjekësore, Tiranë, 1999
Plani i dizajnuar i mësimin:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Lënda , metodat dhe detyrat e fiziologjisë
Java e dytë:	Homeostaza
Java e tretë:	Sistemi i tretjes
Java e katërt:	Lëngjet trupore- Gjaku
Java e pestë:	Imuniteti
Java e gjashtë:	Funksionet e sistemit vaskular- qarkullimi i gjakut
Java e shtatë:	Sistemi i frymëshkëmbimit
Java e tetë:	Vlerësimi i parë intermediar
Java e nëntë:	Sistemi nervor qendror
Java e dhjetë:	Sistemi nervor periferik
Java e njëmbëdhjetë:	Receptorët- shqisat
Java e dymbëdhjetë:	Sistemi endokrin
Java e trembëdhjetë:	Ekskrecioni
Java e katërmëdhjetë:	Energjia dhe metabolizmi
Java e pesëmbëdhjetë:	Vlerësimi i dytë intermediar

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ushtrimet që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Protokolli eksperimental
<i>Java e dytë:</i>	Narkoza dhe anestezioni te kafshët
<i>Java e tretë:</i>	Hematokriti
<i>Java e katërt:</i>	Grupet e gjakut
<i>Java e pestë:</i>	Koagulimi i gjaku
<i>Java e gjashtë:</i>	Eritrocitet si osmometer
<i>Java e shtatë:</i>	Sjellja e eritrociteve ne tretesira izo, hipo dhe hipertone
<i>Java e tetë:</i>	Testi i dilucionit
<i>Java e nëntë:</i>	Pneumografia dhe frymemarrja
<i>Java e dhjetë:</i>	Tretja te shpendët
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Imobilizimi kirurgjik i kafshëve
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Pregaditja e preparatit neuromuskulor
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Analiza e tkurrjes unitare
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Sumacioni dhe tetanusi i tkurrjes muskulore
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Analiza e harkut reflektiv

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit si dhe mbajtja e qetësisë në mësim janë po ashtu të obligueshme.

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore, Departamenti i Biologjisë, Drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit
Titulli i lëndës:	Aplikimi i GIS-it në Ekologji
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I, semestri I
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Departamenti i Gjeografisë
Detajet kontaktuese:	Departamenti i Gjeografisë
Përshkrimi i lëndës	Ky kurs është një hyrje në konceptet bazë të sistemit të informacionit gjeografik (GIS). Pjesa e teorike e kursit është dizajnuar që t'u ofrojë studentëve njohuri themelore rreth bazave të GIS në hartografinë analitike dhe t'i ekspozojë ata se si mund të përdoren informacionet gjeografike për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të zgjidhur problemet. Komponenta e pjesës së ushtrimeve është projektuar për të plotësuar materialin e leksionit dhe për t'u ofruar studentëve përvojë praktike duke aplikuar konceptet e diskutuara në klasë duke ekzekutuar procedurat GIS brenda paketës software Quantum GIS.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është ti mundësojnë studentëve të përdorin GIS-in në zgjidhjen e problemeve të ndryshme në ekologji dhe mjedis si dhe të adresimin e situatave ku përdorimi i GIS-it është i domosdoshëm.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të kursit, studentët do të: <ul style="list-style-type: none"> - mësojnë bazat se si informacionet gjeografike ruhen dhe georeferohen brenda GIS. - Krijojnë bazën e të cilat përdoren për krijimin e hartave. - Përpunojnë dhe analizojnë informacionet gjeografik në formatet raster dhe vektoriale. - Aplikojnë programe të ndryshme të informacionit gjeografik dhe shërbimeve që zakonisht disponohen përmes internetit dhe telefonave celularë sot.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume,seminare	2	15	30
Detyra të shtëpisë	1	14	14
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	1	10	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	2	4
Projektet,prezentimet ,etj	1	3	3
Totali			151
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime, punë praktike në laborator dhe terren, konsultime, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kollokuime, provime.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Total 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	P. Bolstad (2012). GIS Fundamentals: A First Text on Geographic Information Systems, 4th edition. White Bear Lake, MN: Eider Press. M. Law and A.		
Literatura shtesë:	QGIS manual. Electronic version. https://docs.qgis.org/2.8/en/docs/training_manual/		

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Ligjëratat	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet

<i>Java e parë:</i>	Hyrje në GIS
<i>Java e dytë:</i>	Hyrje në Harta
<i>Java e tretë:</i>	Projeksioni i hartave dhe sistemet e kordinatave
<i>Java e katërt:</i>	Kartografia dhe dizajni i hartave
<i>Java e pestë:</i>	Të dhënat dhe tabelat e attributeve
<i>Java e gjashtë:</i>	Digjitalizimi i kordinatave
<i>Java e shtatë:</i>	Funksionet e proksimitetit dhe buferimit. Vlerësimi i parë intermedier
<i>Java e tetë:</i>	Gjeoprocesimi dhe gjeokodimi
<i>Java e nëntë:</i>	Analiza e rrjetave
<i>Java e dhjetë:</i>	Modeli dhe analiza e të dhënave raster
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Krijimi i bazës së të dhënave në GIS
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Modelet e të dhënave hapësinore
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Sistemet satelitore të navigimit dhe hulumtimi i kordinatave
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Remote sensing
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	GIS në Ekologji
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Ushtrimet	
Java	
<i>Java e parë:</i>	Hyrje në GIS. QGIS
<i>Java e dytë:</i>	Manipulimi me harta dhe të dhëna
<i>Java e tretë:</i>	Puna me sistemet dhe projeksionet e kordinatave
<i>Java e katërt:</i>	Simbilizimi i veçorive
<i>Java e pestë:</i>	Etiketimi i veçorive. Krijimi dhe prezantimi i hartave
<i>Java e gjashtë:</i>	Lidhja e të dhënave
<i>Java e shtatë:</i>	Krijimi i veçorive dhe editimi i attributeve
<i>Java e tetë:</i>	Përzgjedhja e veçorive nëpërmjet lokacionit. Përgatitja e të dhënave për analizim.
<i>Java e nëntë:</i>	Analizimi i të dhënave hapësinore
<i>Java e dhjetë:</i>	Adresat e gjeokodimit
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	ESRI
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Mbledhja e të dhënave në teren
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Mbledhja e të dhënave me QGIS
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Teknikat e vizualizimit me QGIS
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Cyber GIS

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit si dhe mbajtja e qetësisë në mësime janë po ashtu të obligueshme.

SYLLABUS i Lëndës Gjenetikë (Bachelor: Ekologji dhe Mbrojtje e Ambientit)

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore, Departamenti i Biologjisë, Drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje e Ambientit
Titulli i lëndës:	Gjenetikë
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti i II-të, semestri dimëror
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	E Enjte, 11- 12 ³⁰
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.Sc. Avdulla J. Alija, Prof. i rregullt Dr.Sc. Fisnik Asllani, asistent
Detajet kontaktuese:	Dhoma nr. 55, tel.: 038-249-872 lok. 225, e-mail.: avdulla.aliya@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë, ofron mundësi për të kuptuar parimet dhe konceptet e gjenetikës. Në përputhje me objektivat e programit, theks i veçantë është vënë në gjenetikën e populacionit si dhe ne interaksionet e forcave dhe proceseve kryesore evolutive.
Qëllimet e lëndës:	Të kuptohen proceset gjenetike në nivel molekular, të qelizës dhe të populacionit; Të kuptohen veçoritë e materialit trashëgues dhe mekanizmat e sintezës së proteinave; Të analizohen ndërrimet në materialin gjenetik dhe pasojat e këtyre ndërrimeve në organizma; Të kuptohen parimet baze të gjenetikës së populacionit, gjenetikës kuantitative dhe evolucionit; Të zhvillohen aftësi që të mblidhen, analizohen dhe prezentohen të dhënat e fituara nga eksperimentet gjenetike.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti pritet që të ketë këto njohuri dhe shkathtësi: Kupton proceset gjenetike në nivel molekular, të qelizës dhe të populacionit; Përshkruan dhe analizon ndërrimet në materialin gjenetik dhe pasojat e këtyre ndërrimeve në organizma; Kupton dhe përshkruan parimet e gjenetikës së populacionit, gjenetikës kuantitative dhe evolucionit; Mbledh, analizon dhe prezenton të dhënat e fituara nga eksperimentet gjenetike

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej/semester
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	///	////	20
Kollokfiume,seminare	////	////	10
Detyra shtepie			10
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	////	///	30
Përgatitja përfundimtare për provim	///	////	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	///	////	5
Projektet,prezantimet ,etj	////	///	5
			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Një ligjeratë dhe një ushtrim teorik ose praktik/laboratorik në javë në kuadër të të cilave do të zhvillohen bashkë-bisedime grupore, seminare, dhe ushtrime numerike.		
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i parë: 30% Vlerësimi i dytë 25% Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera 10% Vijimi i rregullt 5% Provimi final 30% Total 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pierce, B.A. (2018) Genetics Essentials: Concept and Connections, New York. 2. Gjenetika - Material i përgatitur nga ligjeratat dhe ushtrimet 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Hoda, A. (2008) Gjenetika ,Tiranë 2. Griffiths, A. J. F., Miller, J. H., Suzuki, D. T., Lewontin, R. C., Gelbart, W. M., 2000. An Introduction to Genetic Analysis. W.H. Freeman and Company, New York. 3. Russell, P. J., 1998. Genetics. The Benjamin/Cummings Publishing Company, Inc. Menlo Park, California. 		

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje –Historiku dhe zhvillimi i gjenetikës
<i>Java e dytë:</i>	Ligjet themelore të trashëgimisë
<i>Java e tretë:</i>	Citogjenetika dhe determinimi i seksit
<i>Java e katërt:</i>	Ndërrimet në strukturë dhe numër të kromozomeve
<i>Java e pestë:</i>	Krosingoveri dhe rekombinimi i gjeneve
<i>Java e gjashtë:</i>	Trashëgimi jashtëbërthamor
<i>Java e shtatë:</i>	Baza molekulare e trashëgimisë. Replikimi dhe Transkripcioni. <i>Vlerësimi i pare</i>
<i>Java e tetë:</i>	Kodi gjenetik dhe Sinteza e proteinave.
<i>Java e nëntë:</i>	Ekspresioni i gjeneve
<i>Java e dhjetë:</i>	Mutacionet e gjeneve. Riparimi i ADN . Mutagenet mjedisore.
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Elementet Transposable. Gjenomika dhe proteomika.
<i>Java e dymbëdhjete</i>	Imunogjenetika. Gjenetika e Kancerit.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Gjenetika kuantitative- Heritabiliteti, Heterozisi. <i>Vlerësimi i dytë.</i>
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Gjenetika e popullacionit- Ekuilibri i Hardy-Weinbergut
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Gjenetika evolucioniste.

Java	Ushtrimi teorik apo puna praktike/laboratorike që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Metodat statistikore ne Gjenetikë
<i>Java e dytë:</i>	Interaksionet e aleleve nga lokusi i njëjtë; dominimi, recesiviteti, kodominimi, trashëgimi intermediar
<i>Java e tretë:</i>	Interaksionet e aleleve nga lokuset e ndryshme; epistaza, komplementimi
<i>Java e katërt:</i>	Mitoza, Kromosomet
<i>Java e pestë:</i>	Kromosomet politene te D. Melanogaster
<i>Java e gjashtë:</i>	Krosingoveri, hartat e kromosomeve
<i>Java e shtatë:</i>	Ndërrimet në strukturë dhe numër të kromozomeve
<i>Java e tetë:</i>	Trupi i Barr-it
<i>Java e nëntë:</i>	Gjenetika molekulare; replikimi, transkripcioni, kodi gjenetik, translacioni
<i>Java e dhjetë:</i>	Gjenetika molekulare; mutacionet auksotrofe, rregullimi i aktivitetit gjenetik
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Imunogjenetika
<i>Java e dymbëdhjete</i>	Gjenetika kuantitative; trashëgimia e veçorive poligjenike
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Gjenetika e popullacionit; llogaritja e frekuences se aleleve 1
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Gjenetika e popullacionit; llogaritja e frekuences se aleleve 2
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Gjenetika e popullacionit; Faktoret që prishin ekuilibrin gjenetik

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Sjelljet penguese në sallën e mësimit apo në laborator, janë të papranueshme.

Syllabusi I lëndës Herbarizimi

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	FSHMN		
Titulli i lëndës:	Herbarizimi		
Niveli:	Baqelor		
Statusi lëndës:	Zgjedhore		
Viti i studimeve:	III / semestri I gjashtë		
Numri i orëve në javë:	2+1+1		
Vlera në kredi – ECTS:	6		
Koha / lokacioni:			
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.ass.dr. Kimete Lluga-Rizani		
Detajet kontaktuese:	044-448- 354 kimete.lluga@uni-pr.edu		
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë ju ofron studentëve njohuri lidhur me metodologjitë e punës në terren , mbledhjes së materialit floristic dhe konservimit të materialit bimor në Herbarium		
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të fitojnë njohuri të detajuara dhe të specializuara lidhur me metodologjitë e mbledhjes së materialit floristik në terren, metodologjitë e konservimit të materialit floristik të mbledhur në terren, njohja me rolin e Herbariumit si institucion dhe rëndësinë e tij për njohjen e biodiversitetit floristik		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të suksesëshëm të këtij moduli studenti duhet të jetë në gjendje që të: <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruan metodologjitë e punës në terren dhe herbarizimit të materialit bimor • Organizon ekspedita në terren • Konservon materialin bimor me metodat më bashkëkohore • Ndërmerr masa preventive për ruajtjen e materialit të herbarizuar bimor • Ndërton rrjete bashkëpunimi dhe shkëmbimi me Herbariumet e ndryshme institucionale 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokfiume,seminare	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit	1	13	13

(në bibliotekë ose në shtëpi)			
Përgatitja përfundimtare për provim	4	6	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	2	4
Projektet,prezantimet ,etj	2	2	4
			150
Metodologjia e mësimdhënies:			
	Ligjërata, diskutime , punë në grupe, pune ne terren, ne Herbarin e departamentit te Biologjise, prezantime të seminareve etj.		
Metodat e vlerësimit:			
	Vlerësimi I parë 15% Vlerësimi I dytë 15% Vijimi I rregullt 5% Puna praktike në herbar 30% Provimi final 35% Totali 100%		
Literatura			
Literatura bazë:	Nikolič .T. Herbarijski priručnik, Školska knjiga, Zagreb, 1996 Collecting and preserving plant specimens, a manual, Queensland Herbarium August 2016 v 2.1		
Literatura shtesë:	Estero Americano Preserve Herbarium Book, January, 2011 Janine E. Victor, Marinda Koekemoer, Lyn Fish, Shirley J. Smithies, Marthina Mössmer; Southern African Botanical Diversity Network Report No. 25 ; 2004 Herbarium Essentials, The Southern African Herbarium User Manual		

Plani i dizajnuar i mësimi:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Hyrje, Herbari si institucion ,historiku , roli dhe rëndësia
<i>Java e dytë:</i>	Infrastruktura e herbariumit-lokacioni, hapësira, pajisjet etj
<i>Java e tretë:</i>	Nomenklatura, dhe rregullimi I herbarit,s truktura, autorizimi, freskimi sipas të dhënave të reja etj
<i>Java e katërt:</i>	Administrimi I herbarit, pranimi I materialit, dorëzimi, dhe dërgimi,huazimi I material, indeksimi etj
<i>Java e pestë:</i>	Vizitorët e herbarit,shkëmbimi I informatave
<i>Java e gjashtë:</i>	Planifikimi I punës në terren , pajisjet e nevojshme për punën në terren dhe metodologjia e mbledhjes së materialit floristik
<i>Java e shtatë:</i>	Vlerësimi I pare, Planifikimi I punes ne terren-vazhdim
<i>Java e tetë:</i>	Njohja me rreziqet e mundëshme gjatë punës në terren, dhe masat mbrojtëse
<i>Java e nëntë:</i>	Metodologjia e mbrojtjes nga dëmtuesit e herbarit

<i>Java e dhjetë:</i>	Teknikat e herbarizimit dhe konservimit të material floristik të mbledhur në terren
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Metodat e etiketimit të materialit
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Dëmtuesit e herbarit
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Masat e nevojshme mbrojtëse nga dëmtuesit e herbarit
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Menaxhimi I bazës së të dhënave në herbar
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi I dytë, Menaxhimi I bazes se te dhenave ne herbar-vazhdim

Plani i dizajnuar i punës praktike:	
Java	Puna praktike që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Njoftimi me herbarin , veglat dhe mjetet e punës
<i>Java e dytë:</i>	Njoftimi praktik me përdorimin e veglave dhe pajisjeve të herbarit
<i>Java e tretë:</i>	Njoftimi me punë përgatitore për punën në terren
<i>Java e katërt:</i>	Herbarizimi I materiali bimor nga Tipi Pinophyta
<i>Java e pestë:</i>	Herbarizimi I materiali bimor nga Tipi Pinophyta- vazhdim
<i>Java e gjashtë:</i>	Herbarizimi I materiali bimor nga Nenklasa Ranunculidae
<i>Java e shtatë:</i>	Herbarizimi I materiali bimor nga Nenklasa Hammamelidae
<i>Java e tetë:</i>	Herbarizimi I materiali bimor nga Nenklasa Caryophyllidae
<i>Java e nëntë:</i>	Herbarizimi I materiali bimor nga Nenklasa Dillenidae
<i>Java e dhjetë:</i>	Herbarizimi I materiali bimor nga Nenklasa Rosidae
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Herbarizimi I materiali bimor nga Nenklasa Rosidae - vazhdim
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Herbarizimi I materiali bimor nga Nenklasa Asteridae
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Herbarizimi I materiali bimor nga Klasa Liliopsida
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Vizitë një Herbari të ndonjë Sheti fqinjë, apo muzeumit natyror
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Prezantimi I punes finale te studenteve

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<p>Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjëratat dhe ushtrime. Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit si dhe mbajtja e qetësisë në mësim janë po ashtu të obligueshme.</p> <p><u>Në mënyrë që student ti nënshtrohet vlerësimeve obligativisht duhet të vijoj së paku 50% të ligjëratave</u></p> <p><u>Ndalohet fotografimi , inqizimi!!</u></p> <p>Studenti qe nuk përfill politikat akademike I neshtrohet komisionit disiplinor ne nivel te FSHMN-se</p>

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore, Departamenti i Biologjisë, Drejtimi Ekologji dhe Mbrojtje e Mjedisit
Titulli i lëndës:	Herpetologji
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	III sem.V
Numri i orëve në javë:	2+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	11-12.30 e premtë
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Daut Rexhepaj, prof . i rreg.
Detajet kontaktuese:	Nr.tel.044150052e.mail dautrexhepaj@hotmail.com
Përshkrimi i lëndës	
	Ky modul ka te beje me faunen e e reptileve dhe ujetoksoreve. Struktura e amfibieve, origjina dhe evolucioni. Reprodukimi dhe cikli jetesor i tyre. Sjellja dhe distribuimi gjeografik. Ujetoksoret pa kembe (Apoda), me bisht (urodela) dhe pa bisht (anura) - pozita e tyre ne Zoologji. Struktura e reptileve. Reprodukimi dhe cikli jetesor i tyre. Sjellja dhe distribuimi gjeografik i tyre. Breshkat e ujit dhe tokes. Hardhucat, gjarperinjet, rinocefalet dhe krokodilet. Pozita e tyre ne zoologji. Provat paleontologjike mbi origjinen e tyre. Biologjia e ruajtjes dhe zbatimi i saj te reptilet.
Qëllimet e lëndës:	Te aftesohet studenti per pune te pavarur per identifikimin e llojeve qe i takojne herpetofaunes ne terren dhe atyre qe duhet mbrojtur, te projektoje planin për ruajtjen, zhvillimin, kultivimin dhe mbrojtjen e disa shtazëve sic e parashih ligji. Poashtu te njihet mbi shperndarjen e herpetofaunes dhe aktivitetin e tyre jetesor ne planin horizontal dhe vertikal nen ndikimin e faktorve ekologjik.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Qe studenti te njihet - mbi herpetofaunen qe e rrethon dhe me gjere, per rrezikshmerine dhe dobite si dhe te dije te mbrohet ose edhe ti ruaje ato. - Te bej inventarizimin e llojeve dhe te pershkruaj distribuimin e tyre zonal

	<ul style="list-style-type: none"> - Te hartoj listat e llojeve dhe te caktoj shkallen e rrezikshmerise se tyre ne nivelin global dhe te jep mendim mbi shkallen e rrezikshmerise ne nivelin lokal - Te jape mendimin mbi faktoret qe ndikojne ne kete drejtim dhe te propozoj masat te cilat duhet te ndermerren - Te evidentoj llojet helmuese dhe johelmuese dhe te ndikoj ne forma te ndryshme te organizimit, mbrojtjes dhe kujdesit ndaj tyre. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokfiume,seminare	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	13	13
Përgatitja përfundimtare për provim	4	6	24
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	2	2	4
Projektet,prezantimet ,etj	2	2	4
			150
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata tradicionale, zbatimi i strategjive të mësimdhënies dhe të nxënit ndërveprues të cilat nxisin të menduarit konstruktiv përmes leximit dhe shkrimit, punës në grupe, diskutimit, të mësuarit përmes projekteve, zgjedhjes së problemeve, punës laboratorike dhe në terren si dhe prezantime audiovizuale me diaproskop, videoprojektor, grafoskop, CD etj.		
Metodat e vlerësimit:	<p><i>Vlerësimi i parë: 25 %</i> <i>Vlerësimi i dytë: 25%</i> <i>Detyrat e shtëpisë ose angazhime tjera: 10%</i> <i>Vijimi i rregullt: 5%</i> <i>Provimi final: 35%</i> <i>Total: 100%</i></p> <p>The final grade will be calculated as follows: 51%- 60% = 6 61% -70% = 7</p>		

	71% - 80% = 8 81% - 90% = 9 91%-100% =10
Literatura	
Literatura bazë:	1. Herpetologjia (Ligj te auto. 2015) 2. Celesi per determinimin e ujetoksoreve, M. Radovanoviq 3. Celesi per determinimin e amfibieve, I. Haxhiu, Tirane, 1990 4. Celesi per determinimin e reptileve, Prishtine, 2015
Literatura shtesë:	5. Herpetology - Coleman J.Goin & Olive B. Goin) 1982. San Francisko 6. Amphibies and reptiles DadovH. Cambri. 7. Living amphibians in the world.C.H .London

Plani i dizejnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Objekti i studimit dhe rendesia e herpetologjise
<i>Java e dytë:</i>	Struktura e amfibieve
<i>Java e tretë:</i>	Struktura e reptileve
<i>Java e katërt:</i>	Reprodukimi dhe cikli jetesor i amfibieve
<i>Java e pestë:</i>	Reprodukimi dhe cikli jetesor i reptileve
<i>Java e gjashtë:</i>	Sjellja e reptileve dhe amfibieve
<i>Java e shtatë:</i>	Distribrimi gjeografik Vleresimi inermidier
<i>Java e tetë:</i>	Caecilians, Trachystomes and Salamandra
<i>Java e nëntë:</i>	Amfibia pa bisht (anura)
<i>Java e dhjetë:</i>	Breshkat e ujit dhe tokes
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Lacertilia
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Gjarperinjet jo helmues
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Gjarperinjet helmues
<i>Java e katërmëdhjetë:</i>	Rhynocephales dhe crocodilet
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Metodologjia e ruajtjes se shtazeve Provimi final

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata dhe ushtrime. Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit si dhe mbajtja e qetësisë në mësime janë po ashtu të

obligeshme.

Formular për SYLLABUS të Lëndës Hidroekologji

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	FSHMN
Titulli i lëndës:	Hidroekologji
Niveli:	Bsc
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Semestri IV, viti II-te
Numri i orëve në javë:	2+2+1
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	E marte, 10.30, salla C
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr. Sc. Linda Grapci-Kotori, Prof. asoc.
Detajet kontaktuese:	linda.grapci@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Kursi i Hidroekologjisë ne përgjithësi ka të bëjë me njohjen e ekosistemeve ujore, strukturën dhe funksionimin e tyre. Gjatë këtij kursi do te mbulohen në menyre te barabart struktura dhe funksionimi edhe i ekosistemeve të ujerave të njelmëta dhe atyre te ujerave tokësore.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Ky kurs do t'i njoftojë studentët me për se afërmi në fushën e ekologjisë se ujerave nëpërmjet shembujve të shumtë e që do te analizohen me ne hollësi</p> <p>Në pjesën teorike te kursit studentët do të marrin njohuri më moderne rreth struktures dhe funksionimin e ekosistemeve ujore (rezervuarëve të ujit , burimeve) . Gjithashtu do te kene njohure edhe rreth faktorëve abiotik të biotopeve të ujit , studentët do të njihen me biologjinë e kafshëve të ujit , bimëve të ulëta dhe të larta , bakteret dhe me metodat themelore ne hidrobiologji.</p> <p>Ne pjesen praktike studentet do te njihen me punen ne laborator me praktikën laboratorike , në të cilin studentët realizojnë teste te ndryshme ne Hidrekologjii. Pjesa e praktikës mësimore janë ekskursion në vendin dhe jasht vendit ku do te analizohen ekosistemet e ndryshme ujore</p>
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas perfundimit te kursit studentet do te jene ne gjendje te:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Identifikojnë mjediset ujore bazuar në karakteristikat e tyre fizike, kimike dhe biologjike.2. Përshkruajnë historinë e jetës dhe ekologjinë e shumë insekteve ujore, bimëve, peshqve dhe

	<p>organizmave të tjerë ujorë që gjenden në Kosovë</p> <p>3. Parashikojne se si ndryshimet në faktorët biotikë dhe abiotikë do të ndikojnë në habitatet e ujërave të ëmbla.</p> <p>4. Aplikojnë përdornin e çelësave për të identifikuar insektet ujore në nivelin e familjes</p> <p>5. Fiton shkathtesi në aplikimin e teknikave dhe protokoleve të nevojshme për punë në terren për të mbledhur insektet ujore</p>
--	--

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.5	6	3
Kollokfiume,seminare	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	3	10	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	5	5
Totali			150

Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata, diskutime, ushtrime, punë praktike në laborator, konsultime, , detyra shtëpie, kollokuiume, provime.
-------------------------------------	---

Metodat e vlerësimit:	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi në dy kollokuiume 40% • Punë seminarike 10% • Vlerësimi përfundimtar 50%
------------------------------	--

Literatura

Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> • Hidrobiologji, S. Shumka • Ecology of aquatic systems Dobson Michael, Frid Chris 2.ed : Oxford : Oxford University Press : 2009 : xi, 321 s. : ISBN: 978-0-19-929754-2
-------------------------	---

Literatura shtesë:	•Barnes R.S.K., R.N. Hughes, 1999 : An Introduction to Marine Ecology. - 296 p., Blackwell Sci. Publ., Oxford.
---------------------------	--

	<p>ISBN 0865428344..</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cole, G.A., 1994 : Textbook of Limnology. - 412 p., 4th ed., Waveland Press, Long Grove. ISBN: 0-88133-800-1. • Hutchinson, G.E., 1967 : A treatise on Limnology. Vol. I. Geography, Physics, and chemistry. - 1015 p. - J. Wiley Sons, New York. • Hutchinson, G.E., 1977: A treatise on Limnology. Vol. II. Introduction to lake biology and the limnoplankton. 1115 p. - J. Wiley Sons, New York.
--	---

Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Definimi I Hidroekologjisë si shkencë.
Java e dytë:	Karakteristikat fiziko kimike të mjediseve detare.
Java e tretë:	Mjedisi biologjik detar.
Java e katërt:	Planktoni detar
Java e pestë:	Nektoni
Java e gjashtë:	Bentosi
Java e shtatë:	Ekosistemi detar dhe prodhimtaria organike e tij.
Java e tetë:	Mikroorganizamt në mjedisin detar.
Java e nëntë:	Njeriu dhe mjedisi detar
Java e dhjetë:	Jeta në ujëra të njelmëta dhe të te kripura.
Java e njëmbëdhjetë:	Organizmat detare helmuese dhe traumatizuese (biotoksinat) Vleresimi intermedier
Java e dymbëdhjetë:	Limnologjia, faktorët fiziko kimik te mjediseve të ujërave të ëmbla.
Java e trembëdhjetë:	Populacionet dhe funksionimi I një ekosistemi liqenor
